



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



RAPORT VJETOR

Të arriturat për vitin 2023

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Rr. Rrustem Statovci nr. 29,
Prishtinë, 10000

+383 (0) 38 220 040
info@arh-ks.org



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Raport Vjetor 2023

Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për Vitin 2023



Përmbajtja

Lista e figurave	6
Lista e Tabelave	6
Lista e fotove.....	7
1. Përmbledhje Ekzekutive	9
2. Objektivat.....	11
3. Korniza ligjore	11
3.1. Baza ekzistuese ligjore	11
3.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese.....	13
4. Përshkrimi i ARH-së.....	16
4.1. Misioni/Vizioni	16
4.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit.....	16
4.3. Departamenti i Rregullimit të Tregut	16
4.4. Departamenti i Sigurisë	16
4.5. Departamenti i Interoperabilitetit	17
4.6. Departamenti i Licencimit.....	17
5. Fushëveprimi institucional.....	17
5.1. Struktura organizative e ARH-së	17
5.2. Pagat e personelit të ARH-së.....	18
5.3. Skema organizative e ARH-së.....	19
5.4. Bordi mbikëqyrës i ARH-së	20
5.4.1. Mandati.....	20
5.4.2. Kompetencat.....	20
5.4.3. Funksionalizimi	20
5.4.4. Puna e Bordit	20
5.4.5. Numri i mbledhjeve.....	20



5.4.6. Vendimet	21
5.4.7. Arsyetimet për vendimet	21
5.5. Ekzekutivi.....	21
5.5.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.....	21
5.5.2. Menaxhmenti i mesëm	21
5.5.3. Mandati.....	21
5.6. Burimet njerëzore	21
5.6.1. Numri i punëtorëve.....	21
5.6.2. Nevojat për punëtorë të rinj.....	21
5.6.3. Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim	22
5.6.4. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e ARH-së	25
5.6.4.2. Bashkëpunimi me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudha - ERA	25
5.7. Asetet.....	34
5.7.1. Asetet në posedim të institucionit	34
5.7.2. Planet për asete të reja	34
6. Përshkrimi i fushës që e mbulon ARH	34
6.1. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit	34
6.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2023.....	35
6.2.1. Plani i performances së ARH për vitin 2024.....	37
6.3. Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit.....	38
6.4. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues.....	38
7. Puna gjatë vitit raportues	38
7.1. Aktivitetet legislative të ARH-së	39
7.2. Përbushja e obligimeve nga agenda për Integrimin Evropian lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar për Integritet Evropian (PKIE).....	40
8. Përfaqësimet Ligjore	41
8.1. Inspektimet	41



8.1.1. Inspektimi i makinistëve	41
8.1.2. Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore	42
8.1.3. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore	42
8.1.4. Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse NVR	43
9. Monitorimet	44
9.1. Monitorimi i licencave	44
9.2. Monitorimi i tregut hekurudhor.....	44
9.3. Ekspozeu i Rrjetit	45
10. Aplikime të reja.....	46
10.1. Licenca	46
10.2. Shqyrtimi i aplikacioneve për marrjen e Autorizimit dhe Certifikatës së Sigurisë....	46
10.3. Shqyrtimi i aplikacioneve të mjeteve lëvizëse të kompanisë italiane Generale Costruzione Ferroviare - GCF për autorizim dhe regjistrim.....	47
11. Azhurnimi i Regjistrave.....	48
11.1. Regjistri i Licencave në kuadër të ARH-së	48
11.2. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave.....	48
11.3. Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse (NVR)	49
11.4. Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendore rreth HK-së.....	51
11.5. Aktivitetet për rritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore	53
11.5.1. Raporti Vjetor i Sigurisë.....	53
11.6. Fushate vetëdijësuese për të drejtat e udhëtareve.....	53
12. Administrata.....	55
12.1. Financa	55
12.2. Pasqyrat financiare	56
12.2.1. Paga dhe Shtesa	58
12.2.2. Mallra dhe Sherbime.....	58
12.2.3. Shpenzimet Komunale	60
12.2.4. Të hyrat jo tatimore	60



12.2.5. Subvencione dhe transfere.....	61
12.2.6. Shpenzimet kapitale.....	63
13. Prokurimi	68
13.1. Marrëdhëniet me Publikun dhe Qasja në Dokumente Publike.....	69
14. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm	70
15. Shtojcat	71
15.1. Shtojca I - Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës	71
15.2. Shtojca 2. Statistika nga Departamenti i Sigurisë	73
15.3. Shtojca 3.Statistika të Tregut Hekurudhor	76



Lista e figurave

Figura 1. Skema organizative e ARH-ë	19
Figura 2. Skema organizative e ARH-së.....	19
Figura 3. Realizimi i aktviteteve gjatë vitit 2023.....	68
Figura 4. Harta e Hekurudhve në Republikën e Kosovës	72
Figura 5. Numeri i ngjarjeve të jashtëzakonshme.....	74
Figura 6. Numeri i personave të vdekur.....	74
Figura 7. Numeri i personave të lënduar.....	75
Figura 8. Dëmet materiale.....	75
Figura 9. Transporti i mallrave në neto/ton për vitet 2021/22/23	76
Figura 10. Transporti i udhëtarëve për vitin 2021/22/23	77

Lista e Tabelave

Tabela 1. Lista e shkurtesave	8
Tabela 2. Trajnimet dhe përfaësimet kryesore gjatë vitit 2023	22
Tabela 3. Planifiki i punës për vitin 2023 dhe realizimi	35
Tabela 4. Kompanitë hekurudhore të inspektuara (NVR, EVN dhe VKM).....	43
Tabela 5. Makineria / mjetet levizëse hekurudhore punuese	47
Tabela 6. Marrëveshjet ndërkufitare dhe vendore hekurudhore të Kosovës	51
Tabela 7. Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2023	56
Tabela 8. Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH-ë për vitin e përfunduar me 31 dhejtor 2023.....	56
Tabela 9. Pasqyrat e shpenzimeve në kategorinë paga dhe shtesa	58
Tabela 10. Pasqyrat e shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime.....	58
Tabela 11. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë Shpenzime Komunale	60
Tabela 12. Pasqyra e të hyrave jo tatimore	60



Tabela 13. Pasqyra në kategorinë subvencione dhe transfere.....	61
Tabela 14. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale	63
Tabela 15. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale, subvencione dhe trenasfere, si dhe shpenzimeve kapitale për vitin 2023 (Janar –Dhejtor 2023)	64
Tabela 16. Kërkesat e pranuar për qasjen në dokumentet publike, në tri vitet e fundit	69
Tabela 17. Jane paraqitur aksidentet dhe incidentet te cilat kanë ndodhur nëpër komuna gjatë viteve 2019-2023	73
Tabela 18. Janë paraqitur ngjarjet e jashtëzakonshme, numri i personave të vdekur, numri i personave të lënduar dhe dëmet materiale në Hekurudhat e Kosovës, për periudhën pesë vjeqare 2019-2023	73
Tabela 19. Transporti i mallrave në neto/ton për vitet 2021/22/23.....	76
Tabela 20. Transporti i udhëtarëve për vitet 2021/22/23.....	77

Lista e fotove

Foto 1. Samitin e Ekselencës Hekurudhore të Ballkanit Perëndimorë	26
Foto 2. Punëtori -Lidhje Automatike Dixhitale DAC.....	27
Foto 3. Punëtori mbi rregullimin ekonomik të transportit	27
Foto 4. Misioni i ekspertëve TAIEX në përgatitje për transpozim të Specifikacioneve për mjete lëvizëse.....	28
Foto 5. Misioni ekspertëve TAIEX lidhur me procesin e vendosjes në shërbim të linjës 10 në pëputhje me specifikimet teknike për inteoperabilitetit - STI	29
Foto 6. Asambleja Plenare e 23/24 Maj IRG-Rail.....	29
Foto 7. Asambleja Plenare e 28/29 Nentorit IRG-Rail	30
Foto 8. Misioni i ekspertëve TAIEX për alokimin e infrastrukturës hekurudhore.....	31
Foto 9. Vizitë Studimore në lidhje me lëndët djegëse alternative për hekurudhat.....	32
Foto 10. Takim i 62 - 63 dhe 64 i rrjetit të NSA të BE-së	33
Foto 11. IPA Workshop "Train Driver training and licensing.....	33
Foto 12. Takimi i Nen Komitetit Infra mbajtur virtualisht me përfaqësuesit e Komisionit Evropianë në Bruksel.	40
Foto 13. Pasqyron komunikimi dhe njoftimin e udhëtareve me te drejtat e tyre.....	54



Shkurtesat

Tabela 1. Lista e shkurtesave

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BE	Bashkimi Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
EC	European Commission (Komisioni Evropian)
ERA	European Union Agency for Railway (Agjensioni i Bashkimit Evropian i Hekurudhave)
ERR	Ekspozeu i Rrjetit
ERTMS	The European Rail Traffic Management System (Sistemi Evropian i Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor)
GCF	Generale Costruzioni Ferroviarie S.p.A (Kompania italiane e përzgjedhur për rehabilitimin e linjës së 10-të)
HK	Hekurudhat e Kosovës
INFRAKOS	Menaxheri i Infrastrukturës- "Hekurudhat e Kosovës Infrakos" Sh.A.
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
IRG-Rail	Independent Regulatory Group-Rail
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MMPHI	Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinore dhe Infrastrukturës
PKIE	Plani Kombëtar për Integritet Evropian
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit
NH	Ndërmarrje hekurudhore
NSA	National Safety Authority
NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
OB	Organizatat Buxhetore
RAILTRANS	Operator privat për transport të mallrave
SMS	Safety Management System (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (Technical Specification for Interoperability)
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange instrument of the European Commission (Instrumenti i Komisionit Evropian për Asistencë Teknike dhe Shkëmbim të Informatave)
TCT	Traktati i Komunitetit të Transportit
TRAINKOS	Operimi me Trena - "Hekurudhat e Kosovës Trainkos" Sh.A.
VKM	Vehicle Keeper Marking (Shenjëzimi i Mbatjesit të Mjetit Lëvizës)



1. Përmbledhje Ekzekutive

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH), për periudhën raportuese 01 janar-31 dhjetor 2023 ka përgatitur Raportin Vjetor i cili pasqyron të arriturat dhe zhvillimet kryesore institucionale në fushën e hekurudhave. Ky raport përveç pjesës së përgjithshme, përshkruan gjerësisht edhe aktivitetet dhe përgjegjësitë e funksionimit siç janë: Licencimi, Siguria, Interoperabiliteti, Rregullimi i Tregut, Administratës dhe Financave. Po ashtu, në këtë raport janë të përfshira edhe sfidat me të cilat është përball ARH në punën dhe aktivitetet e saj gjatë vitit raportues.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës (LH) i cili është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së, është përcaktuar edhe roli dhe funksionimi i ARH-së. Pra, ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ngarkuar me përgjegjësitë për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit hekurudhor në Kosovë. ARH në punën dhe vendimet e saj ofron transparencë dhe jo diskriminim për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Kosovë.

Raporti në tërësi ofron informacion mbi: bazën ligjore, përshkrimin dhe organizimin institucional, përshkrimin e fushave që mbulon ARH, punën gjatë vitit paraprak, sfidat, raportin financiar, raportin rreth rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm si dhe anekset.

Duke qenë se ARH vepron si organ për Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut, edhe përmbajtja e raportit elaboron me specifikisht progresin dhe arritjen e objektivave të saj kryesisht në këto fusha. Gjatë vitit 2023 ARH ka vazhduar të ushtrojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

Licencimi: Është organ përgjegjës për lëshimin e licencave për menaxherin e infrastrukturës, ndërmarrjet hekurudhore dhe makinistët, si dhe bënë amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre licencave. Gjatë vitit raportues, ka realizuar një sërë aktivitete me përkushtim dhe angazhim maksimal si: shqyrtimi i aplikacioneve të reja për licenca të makinistëve, monitorimi i licencave të lëshuara, inspektimet për makinistët e licencuar, hartimi i raporteve të veçanta për aktivitetet e lartcëkura, përditësimi i regjistrit të licencave dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin që e rregullon këtë fushë.

Siguria: Organi i Sigurisë punën dhe aktivitetin e vet gjatë vitit paraprak kryesisht e ka bazuar në Planin Vjetor të Punës. Fokusi kryesor i punës ka qenë i bazuar në disa shtylla kryesore siç janë: kërkesat që dalin nga Ligji i Hekurudhave, përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga Planin Kombëtar për Integritet Evropian (PKIE), Traktati i Komunitetit të Transportit TCT dhe pjesëmarrje në evente profesionale nga fusha e Sigurisë të organizuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudha (ERA) si dhe pjesë e zbatimit të Obligimeve të cilat rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Transportit. Gjatë vitit 2023 është përgatitur Raporti Vjetor i Sigurisë për vitin 2022, siç parashihet me Ligjin aktual të Hekurudhave, inspektimin e të gjitha linjave dhe mjeteve lëvizëse në menaxhim të Infrakos-it, si dhe inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse në menaxhim të Trainkos-it, Railtrans-it dhe Ferronikel-it. Pas procesit të inspektimit janë përgatitur raportet me rekomandime për të gjitha të gjeturat gjatë inspektimeve dhe janë dërguar te kompanitë përkatëse. Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë gjatë vitit raportues është realizuar vazhdimi i njohjeve të Autorizimeve të përkohshme të makinerive/mjeteve punuese lëvizëse hekurudhore, sipas kërkesës



së ndërmarrjes punuese në rehabilitimin e linjës 10, kompanisë italiane G.C.F. GENERALE COSTRUZIONI FERROVIARIE S.p.A., si dhe janë lëshuar Autorizimet për futje në shërbim për mjetet e mirëmbajtjes, sipas kërkesës së Menaxherit të Infrastrukturës-INFRAKOS.

Interoperabiliteti: Për të zhvilluar kornizën nacionale të interoperabilitetit hekurudhor, me qëllim të harmonizimit të sistemit hekurudhore me rregullat dhe standardet evropiane të obligueshme për Kosovën, Departamenti për Interoperabilitet ka realizuar aktivitetet si: përgatitja e rregullores për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin "aplikacione telematike për shërbimet e mallrave" STI TAF, si obligim që derivonë nga Ligji i Hekurudhave dhe agjenda e integritetit evropian, saktësisht nga Traktati i Komunitetit të Transportit. Përveç kësaj, është mbajtur dhe punëtorja pesëditore e organizuar nga TAIEK me qëllim të ofrimit të këshillave dhe udhëzimeve në harmonizim të legjislacionit për interoperabilitetin hekurudhor në përputhje me ligjin dhe praktikën e BE-së. Gjithashtu, është realizuar draftimi i rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 05/2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR), edhe në këtë rast mbështetur me ekspertë të BE-së, përmes TAIEK-it.

Ndërsa, si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të ARH-së, me dt.: 22.08.2023 përmes përfaqësuesit nga Agjensioni Evropian i Hekurudhave - ERA, jemi njoftuar që Drejtori Ekzekutiv ERA - së ka vendosur më 21 qershor 2023 që Kosova do të jetë në gjendje të përdorë kodin numerik dyshifror "00" për "të gjitha shtetet/territoret e tjera përkohësisht derisa të gjendet një zgjidhje përfundimtare. Kjo zgjidhje ka përparësinë, që Kosova mund të ketë qasje në EVR dhe regjistrimet ekzistuese mund të mos kenë nevojë të ndryshohen. Tani, nga ky vendim do të mundësohet qasja e Kosovës (Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore - NVR (National Vehicle Railway) në Regjistrin Evropian të Mjeteve Lëvizëse - EVR (European Vehicle Register) në nivel të Bashkimit Evropian. E konsiderojmë të arritur që Kosova do të mund të përdorë kodin numerik dyshifror "00" për të gjitha shtetet dhe territoret tjera përkohësisht, deri në gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare pas vendimit të Agjencionit Evropian i Hekurudhave - ERA. Në lidhje me këtë zyrtarisht janë njoftuar të gjitha institucionet relevante për hekurudha.

Çështje e rëndësishme për raportim, tani mbetet fillimi i procesit të ndërlidhjes së regjistrit NVR me Regjistrin Elektronik Evropian, në koordinim dhe bashkëpunim me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudha-ERA dhe Sekretariatit të Transportit –TCT.

Gjithashtu, Departamenti i Interoperabilitetit ka realizuar Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse – NVR, përfshirë edhe përditësimin e këtij regjistri, inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse të regjistruara, përcjellur me raportet me rekomandime.

Rregullimi i Tregut: Organi përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, gjatë vitit raportues ka zhvilluar aktivitete siç janë: shqyrtimi i komenteve për tregun hekurudhor, iniciimin dhe mbajtjen e procesit të konsultimeve me palët e interesit për Ekspozeun e Rrjetit 2024 duke siguruar që Ekspozeu i Rrjetit të mos përmbajë klauzola diskriminuese, dhe mbikëqyrja e implementimit të Ekspozeut të Rrjetit 2024. Aktivitet tjetër ka qenë monitorimi marrëveshjes mbi qasje në binar për vitin 2023, në mes të menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore. Gjithashtu, është bërë edhe monitorimi i tregut hekurudhore si dhe është përgatitur Raporti Vjetor i Monitorimit të Tregut 2022 si dhe raporti elektronik i monitorimit të tregut i dërguar në IRG-Rail, për vitin 2022. Departamenti i Rregullimit të Tregut ka bashkëpunuar me institucionet dhe ndërmarrjet vendore dhe organet e tjera rregullative të tregut



hekurudhor, veçmas sa i përket partnerëve të IRG – Rail, në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor me vendet e tjera. Gjatë vitit 2023 kemi përgaditur draft-Rregulloren për procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kornizë për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, e cila është mbështetur edhe me mision të eksperteve të TAIEK.

2. Objektivat

ARH do të vazhdojë të jetë një rregullator aktiv dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend. Jemi të bindur se në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta në vitet e ardhshme presim të kemi rezultate më të mira në sektorin e transportit hekurudhor, veçanërisht duke pasur parasysh planifikimin për projekte të reja ndërshtetërore ku vend qendror zë modernizimi i linjës së 10 dhe projekti hekurudhor Prishtinë-Durrës.

ARH, edhe më tej vazhdon të ketë qëllim kryesor zhvillimin e një sistemi efikas dhe të sigurt të transportit hekurudhor, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së, që promovon zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e shërbimeve të transportit hekurudhor.

3. Korniza ligjore

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

3.1. Baza ekzistuese ligjore

- Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063;
- Ligji Nr. 06/L-067 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat E Kosovës;
- Rregullore e Brendshme e ARH për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm dhe Sistemin e Vendeve të Punës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012, për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012, për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012, për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore;
- Rregulloren Nr. 01/2012, për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Rregullore Nr. 03/2012, për Certifikatat e Sigurisë;
- Rregullore Nr. 05/ 2012, për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore. Kjo rregullore transponon Direktivën 2008/57/EC dhe Vendimin 2007/756/EC;
- Rregullore Nr. 06/ 2012, për Regjistrimin e Infrastrukturës;
- Rregulloren Nr. 01/2013, për Ekspozeun e Rrjetit;
- Rregulloren Nr. 02/2013, për Licencimin e Makinistëve;



- Rregullore Nr. 01/2014, për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 201/2011/EU;
- Rregullore Nr. 01/2017, për Taksa dhe Gjobat;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Raportimin e Monitorimit të Tregut Hekurudhor;
- Rregullore Nr. 03/2017 për Të Drejtat e Udhëtarëve;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore;
- Rregullore Nr. 05/2017, Metodën e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut;
- Rregullore Nr. 06/2017 për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të ARH-së;
- Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Operatorëve Hekurudhor me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2017;
- Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherit të Infrastrukturës me Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2017;
- Rregullorja nr. 01/2018 për llogaritjen e kostos direkte. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/909 / BE;
- Rregullorja nr. 02/2018 për metodën e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e certifikatave të sigurisë hekurudhore. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 1169/2010 / BE;
- Rregullorja nr. 03/2018 për ndërtimin, përmirësimin, ripërtëritjen, vlerësimin e konformitetit dhe autorizimin për funksionalizimin e mjeteve lëvizëse. Kjo Rregullore transponon pjesërisht direktivat dhe rregulloret e BE si: 2004/49 / EC, 2008/57 / EC, 2009/131 / EC, 2008/110 / EC si dhe Rregullorja nr. 402/2013 / BE;
- Rregullorja nr. 04/2018 për Caqet e Përbashkëta të Sigurisë (CST). Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2010/409 / BE;
- Rregullorja Nr. 05/2018 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin 'Infrastrukturë' STI INF. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së nr. 1299/2014;
- Rregullorja nr. 06/2018 për përdorimin e një formati të përbashkët evropian për certifikatat e sigurisë, dokumentet e aplikimit dhe vlefshmërinë e certifikatave të sigurisë. Kjo rregullore transponon rregulloren e BE-së nr. 653/2007 / EC;
- Rregullorja Nr.07 / 2018 për miratimin e një metode të përbashkët të sigurisë për vlerësimin e arritjes së objektivave të sigurisë. Kjo rregullore transponon Vendimin e BE-së Nr. 2009/460 / BE;
- Rregullorja Nr. 08 / 2018 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin 'Operimit dhe Menaxhimit të Trafikut' STI OPE. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/995;
- Rregullore Nr. 01/2019 për certifikimin e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e vagonave të mallrave;
- Rregullore Nr. 02/2019 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin "mjetet lëvizëse – lokomotivat dhe mjetet lëvizëse për udhëtar" STI LOC&PAS. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 1302/2014;



- Rregullore Nr. 03/2019 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsisteme “mjetet lëvizëse – vagonët për transportin e mallrave” STI WAG. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 321/2013;
- Rregullorja Nr.03/2020 për Licencim;
- Rregullorja Nr.04/2020 për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin “kontroll-komandë dhe sinjalizim” STI CCS. Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 2016/919;
- Rregullore Nr. 01/2021 Për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Monitorim, e cila aplikohet nga ndërmarrja hekurudhore, menaxheri i infrastrukturës pas marrjes së certifikatës apo autorizimit të sigurisë, është miratuar nga bordi i ARH me dt:30.06.2021. (Kjo rregullore transponon rregulloren, Commission Regulation (EU) No 1078/2012

3.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Ndër vite, ka qenë kërkesë e ARH plotësim/ndryshimi i ligjit aktual për HK. Gjatë vitit 2023, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës ka ndërmarrë veprime konkrete në këtë drejtim, duke krijuar vendimin për themelimin e Grupit Punues-GP për hartimin e koncept dokumentit për plotësim/ndryshimin e Ligjit të Hekurudhave, pjesë e së cilës ishte edhe ARH. Krijimi i ligjit të veçantë për Siguri dhe Interoperabilitet, dhe në anën tjetër Ligji i ri për Hekurudhat e Kosovës janë kërkesë e vazhdueshme e Sekretariatit të Transportit të cilat janë bazë për hartimin e koncept dokumentit. Si rezultat, koncept dokumenti i hekurudhave është miratuar më datën 22.11.2023.

Për më tepër edhe Raporti i Progresit ndër vite kërkon nga institucionet e Kosovës që të bëhet përditësimi i legjislacionit në fuqi për sektorin e hekurudhave, më qëllim transpozimin e legjislacionit të BE-së, me theks të veçantë aplikimin e Pakos së Katërt Hekurudhore. Ligji i ri për Siguri dhe Interoperabilitet ka qenë kërkesë e veçantë në Raportin e Progresit për Kosovën 2022.

Paketa e 4-të hekurudhore është një set prej 6 tekstesh legjislative të dizajnuara për të heqë barrierat e mbetura për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane. Legjislacioni i propozuar synon reformimin në sektorin hekurudhor duke inkurajuar konkurrencën dhe inovacionin në hekurudha. Rezultati përfundimtar duhet të jetë nivele më të larta sigurie, interoperabilitet dhe besueshmërie në rrjetin hekurudhor. Ai përfshin "shtyllën teknike" dhe "shtyllën e tregut". Shtylla teknike nënkupton aspektet e sigurisë dhe të interoperabilitetit, kurse ajo e tregut ka të bëjë me hapjen apo liberalizimi i tregut hekurudhor.



Ndërsa sa i përket akteve nënligjore për të cilat ARH është përgjegjëse sipas LH, janë përgatitur projekt rregulloret si në vijim, të cilat në mungesë të Bordit Mbikqyrës, përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore kanë mbetur të pamiratuara.

- Projekt Rregulloren për Specifikacione Teknike për Interoperabilitet në lidhje me qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar. Kjo rregullore do të transpozoi Commission Regulation (EU) No 1300/2014 of 18 November 2014 on the technical specifications for interoperability relating to accessibility of the Union's rail system for persons with disabilities and persons with reduced mobility; është planifikuar për miratim në (e planifikuar për miratim në K4 2021);
- Projekt Rregullore për specifikacionet teknike për interoperabilitet në lidhje me nënsistemin "aplikimet telematike për shërbimet e pasagjerëve" STI TAP, kjo rregullore transponon "Commission Regulation (EU) No 454/2011 of 5 May 2011 on the technical specification for interoperability relating to the subsystem 'telematics applications for passenger services' of the trans-European rail system"(e planifikuar për miratim në K4 2022);
- Projekt Rregullore për miratimin e parametrave baze për regjistrat e licencave për drejtim treni dhe certifikatave plotësuese, kjo rregullore transponon "Commission Decision 2010/17/KE of 29 October 2009 on the adoption of basic parameters for registers of train driving licences and complementary certificates provided for under Directive 2007/59/EC of the European Parliament and of the Council (notified under document C(2009) 8278) (Text with EEA relevance)." (e planifikuar për miratim në K3 2022);
- Projekt Rregullore për Specifikacionet teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin "aplikacionet telematike për mallra"- STI TAF. Kjo projekt rregullore adopton Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1305/2014 e datës 11 dhjetor 2014 (e planifikuar për miratim në K4 2023);
- Projekt Plotësim/ndryshim i Rregullores nr. 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse. Ky plotësim ndryshim adopton Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2018/1614 i datës 25 tetor 2018 (e planifikuar për miratim në K4 2023);
- Projekt rregullore për "Procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kornizë për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore". Kjo projekt rregullore transponon rregullore e Komisionit për Zbatim (BE) 2016/545 e datës 7 Prill 2016 mbi procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kuadër për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, OJ BE L 94, 8.4.2016, f. 1 (planifikuar për miratim në K3 2023);
- Projekt Rregullores për kryqëzimet hekurudhë-rrugë, ref. nga Direktiva e Komisionit 2014/88/BE e datës 9 korrik 2014 që ndryshon Direktivën 2004/49/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me treguesit e përbashkët të sigurisë dhe metodat e zakonshme të llogaritjes së kostove të aksidenteve (Level crossings - European Union common safety indicators , ref. Commission Directive 2014/88/EU of 9 July 2014 amending Directive 2004/49/EC of the European Parliament and of the Council as regards common safety indicators and common methods of calculating accident costs) (planifikuar për miratim në K4 2023);

**Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet**

ARH identifikon dhe raporton vështirësitë ligjore ndër vite, për të cilat vlerëson se ndikojnë në zbatimin efektiv të LH. Gjatë zbatimit kemi hasur në disa paqartësi rreth kompetencave ndër institucionale, me theks të posaçëm mes ARH-së dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës MMPHI, si dhe mos përputhshmërisë me disa nga Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e transportit hekurudhor. Këto vështirësi janë evidente që nga hyrja në fuqi e LH në fillim të vitit 2012.

ARH raporton se gjatë periudhës raportuese ka pasur veprime konkrete në ndryshim të legjislacionit, konkretisht hartimi i koncept dokumenti për hekurudha, i cili do t'i hap rrugë hartimit të Ligjit të ri për Hekurudha dhe Ligjit të Ri për Siguri dhe Interoperabilitet, përmes të cilave do të qartësohen, ndër të tjera, edhe kompetencat ndër institucionale, pavarësisht faktit se ARH një gjë të tillë e ka kërkuar në vazhdimësi, vite më parë.



4. Përshkrimi i ARH-së

ARH është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa aktualisht funksionon sipas Ligjit 04L-063. ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

4.1. Misioni/Vizioni

Misioni - Misioni i ARH-së është rregullimi dhe mbikëqyrja e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

Vizioni - Vizioni i ARH-së është që të ofroj shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

4.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit

Sipas LH, ARH rregullon dhe mbikëqyrë katër fusha specifike përmes këtyre departamenteve profesionale:

4.3. Departamenti i Rregullimit të Tregut

Departamenti i pavarur, përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, monitorimi i tërë tregut hekurudhor në Kosovës, shqyrtimin ankesave për tregun hekurudhor, monitorimin e marrëveshjes për kompensimin e obligimeve të shërbimeve publike, sigurimin se pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese, pastaj sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese. Gjithashtu është përgjegjës për negociatat ndërmjet palëtueseve dhe menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelin e pagesës për infrastrukturë, dhënien e kontributit për të zhvilluar sistem të integruar të transportit të udhëtareve dhe mallrave dhe të tjera përgjegjësi të përcaktuara në LH.

4.4. Departamenti i Sigurisë

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH-së për të siguruar që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendimmarrjen nga ndonjë ndërmarrje hekurudhore, menaxher i



infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit. Gjithashtu ky departament është përgjegjës për lëshimin, rinovimin, amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e autorizimit dhe certifikatave të sigurisë, autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor, mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar, mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore, mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës.

4.5. Departamenti i Interoperabilitetit

Departamenti i Interoperabilitetit brenda ARH-së është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së, në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova. Kushtet në lidhje me interoperabilitetin përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit e gjithashtu edhe kualifikimeve profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon në operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

4.6. Departamenti i Licencimit

Departament i Licencimit është organ i pavarur dhe përgjegjës për lëshimin e licencave për Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore, Ndërmarrjet Hekurudhore dhe për Makinistët të Trenit. Gjithashtu, ky departament bënë mbikëqyrjen, amendamentin, dhe suspendimin e licencave të lëshuara për subjektet hekurudhore në Kosovë, si dhe inspektimin e licencave për makinistë të trenit. Departamenti i Licencimit bënë azhurnimin e regjistrit të licencave për operatorët hekurudhore dhe makinistët e trenit.

5. Fushëveprimi institucional

5.1. Struktura organizative e ARH-së

Struktura e ARH-së, miratohet nga Bordi dhe përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Struktura organizative e ARH-së në bazë të Ligjit të Hekurudhave dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës, përbëhet nga:

- a) Bordi Mbikëqyrës;
- b) Drejtori i Përgjithshëm;
- c) Departamenti Ligjor/Licencim;
- d) Departamenti i Sigurisë;
- e) Departamenti i Interoperabilitetit;
- f) Departamenti i Rregullimit Tregut;



- g) Departamenti i Administratës;
- h) Departamenti i Financave;

Në bazë të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës është paraqitur struktura organizative e ARH-së. Gjatë vitit 2021 është punuar për plotësim/ndryshim të strukturës së brendshme të ARH-së, me qëllim që struktura e ARH-së të jetë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.06/L-113 për Funksionimin dhe Organizimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Në mungesë të Bordit të ARH-së rregullorja ka mbetur e pa finalizuar.

5.2. Pagat e personelit të ARH-së

ARR-ja siguron që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës të funksionoj në përputhje me Ligjin e Hekurudhave dhe standardet e BE-së. Për ta arritur këtë, rregullatori i hekurudhave të Kosovës ka nevojë për personel të kualifikuar dhe me përvojë për t'i hartuar standardet, procedurat, rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga operatorët përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe inspektimeve. Përkundër kësaj, niveli i pagave të personelit të ARH-së që nga themelimi vazhdon që të jetë mjaft i ulët në krahasim me pagat e personelit të industrisë së hekurudhave dhe rregullatorëve tjerë të pavarur. Personeli i ARH nuk gëzon asnjë kompensim shtesë përveç pagës bazë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Si rezultat, ARH rrezikon humbjen e stafit profesional aq më tepër në këtë kohë kur investimet janë drejtuar seriozisht në këtë sektor.

5.3. Skema organizative e ARH-së




Figura 1. Skema organizative e ARH-ë



5.4. Bordi mbikëqyrës i ARH-së

Veprimtaria e ARH-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi ARH-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe njëri prej tyre zgjidhet Kryesues, anëtari i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Takimet e Bordit drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në muaj. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk ka kuorum. Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.

5.4.1. Mandati

Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet Kryesuesi i Bordit të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë. Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohet më së shumti edhe për një (1) mandat.

5.4.2. Kompetencat

Bordi mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e aktiviteteve dhe vendimeve të ARH-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore, siç janë: licencimi, siguria, interoperabiliteti si dhe rregullimi tregut dhe aspekteve të menaxhimit financiar, të hyrave dhe shpenzimeve të ARH-së. Bordi i ARH-së, miraton të gjitha aktet nënligjore të departamenteve të cilat janë në kuadër të saj.

5.4.3. Funksionalizimi

ARH-ja nga data 21.07.2021 funksionon pa Bord Mbikëqyrës, si rezultat i Vendimit të Kuvendit të Kosovës Nr. 08-V-040 për shkarkimin e Bordit të ARH-së.

5.4.4. Puna e Bordit

Bordi Mbikëqyrës i ARH-së, punën dhe përgjegjësinë e vet e kryen bazuar në kompetencat ligjore që ka. Puna e Bordit është e fokusuar në mbikëqyrjen e realizimit të punëve dhe detyrave të institucionit si dhe në vendimarrjen në proceset që janë në kompetencë të Bordit.

5.4.5. Numri i mbledhjeve

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, Bordi Mbikëqyrës, duhet të mbajë të paktën një mbledhje në çdo muaj, dhe mund të zhvilloj edhe mbledhje tjera, varësisht sipas nevojave dhe kërkesave.



5.4.6. Vendimet

Në mungesë të Bordit nuk ka pasur vendime.

5.4.7. Arsyetimet për vendimet

Nuk ka pasur vendime.

5.5. Ekzekutivi

5.5.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e punëve të përditshme dhe në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga Bordi. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga Bordi Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për Shërbimin Civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord, nuk ka të drejtë të emërohet as Drejtor i Përgjithshëm.

5.5.2. Menaxhmenti i mesëm

Menaxhmenti i mesëm i ARH-së përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve dhe menaxherët të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre të përshkruara me detyrat e punës. Drejtori i Përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara sipas Rregullores së Brendshme dhe mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e ARH-së një strukturë apo punonjësi jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture, nëse e sheh të nevojshme.

5.5.3. Mandati

Drejtori i Përgjithshëm emërohet me mandat me kohë të caktuar.

Nëpunësit tjerë civil të ARH-së mbajnë Akte Emërim me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

5.6. Burimet njerëzore

5.6.1. Numri i punëtorëve

Aktualisht ARH-ja ka 19 nëpunës civil. Gjatë vitit 2023 kemi pasur një dorëheqje nga pozita.

5.6.2. Nevojat për punëtorë të rinj

ARH ka nevojë për punëtorë të rinj shtesë në mënyrë që të përmbush mandatin e vet ligjor. Sidomos, pas fillimit të punimeve në rehabilitim të linjave hekurudhore edhe investimet që kanë filluar në sektorin e hekurudhave e që pritet të rrisin volumin e punëve edhe për ARH-në, në aktivitetet mbikëqyrëse dhe inspektuese.



5.6.3. Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim

Zyrtarët e ARH-së gjatë vitit 2023 kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme online dhe me prani fizike, kryesisht organizuar nga ERA në vende të BE-së, Sekretariati i Transportit, si dhe në vende tjera të regionit. Po ashtu, zyrtarët e ARH-së gjatë vitit raportues kanë ndjekur trajnime brenda vendit, të organizuara nga institucionet kompetente siç janë: Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), etj.

ARH, krahas zhvillimeve të reja, në vazhdimësi ka nevojë për ngritje të kapaciteteve profesionale. Me qëllim të ngritjes së këtyre kapaciteteve, zyrtarë nga ARH kanë ndjekur trajnimet e nevojshme në fushën e licencimit, sigurisë, interoperabilitetit, rregullimit të tregut si dhe në fushat tjera mbështetëse, si: administratë, financa, resurse humane dhe prokurim.

Trajnimet dhe punëtoritë kryesore janë paraqitur në formë tabelare si në vijim:

Tabela 2. Trajnimet dhe përfaësimet kryesore gjatë vitit 2023

Nr.	Trajnimi/Eventi	Organizatori
1	TAIEX - KS - “Expert Mission on Allocation of rail infrastructure”	TAIEX & ARH
2	Hartimi dhe përgatitja e deklaratave dhe kampanjave informuese	Instituti i Kosovës për Administratë Publike- IKAP
3	Samiti i Hekurudhave për Ballkanin Perëndimor 2023	Traktati i Komunitetit të Transportit TCT dhe ERA
4	IPA Workshop për Licencimin e Makinistëve	Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudhat – ERA
5	Procesi i Klasifikimit të Vendeve të Punës për Zyrtarët Publik	Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik - DMZP
6	Reforma në Administratën Publike	Instituti për Kontabilitet Auditim dhe Financa – IKAF
7	Planifikimi i Parasë së Gatshme	Thesari, MFPT



8	Takimi i 7 -23 Mars 2023 Nën Komitetit	Bashkimi-Evropian-Kosova Nënkomiteti për transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal
9	Misioni i Ekspertëve-TAIEX - KS - Procedurat e Vendosijes në Shërbimin të Linjes 10 në përputhje me Specifikimet Teknike për Interoperabilitet – STI	TAIEX & ARH
10	Asambleja Plenare e IRG-Rail	IRG- Rail
11	Eventi hekurudhor Euroasia Rail 2023	Euroasia Rail/Stamboll - Turqi
12	Prezantimi i planit kontabël të përditësuar dhe udhëzuesit të planit kontabël	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
13	TAIEX - KS - Misioni i Ekspertëve për Transpozimin e Specifikimeve për mjetet lëvizëse	TAIEX & ARH
14	Analiza Statistikore dhe Interpretimi	Instituti i Kosovës për Administratë Publike-IKAP
15	IPA- Mallrat ne Transportin Hekurudhore dhe Demonstrimi i lidhjes automatike digjitale -DAC	ERA dhe TCT
16	Planifikimi i burimeve njerëzore dhe hartimi i planit të personelit	Instituti i Kosovës për Administratë Publike-IKAP
17	Vizitë studimore - IPA Study Visit related to alternative fuels for railways(hydrogen fuel cells) and battery electric trains	ERA



18	Tendencat e fundit dhe perspektiva e pavarur në rregullimin ekonomik të transportit.	Autoriteti Rregullator i Transportit (ART)-Itali
19	Rëndësia e parandalimit të konfliktit të interesit dhe roli i Autoriteteve Përgjegjëse sipas Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit-APK
20	Asambleja e parë Plenare e IRG-Rail	Grupi i Rregullatorëve të Pavarur-IRG- Rail
21	Menaxhimi i Rrezikut	IKAP
22	Regjistrimi i pasurive kapitale në SIMFK”	Thesari i Kosovës
23	Ndihma Shtetërore në Kosovë, Përgjegjësitë e dhënësve të ndihmës shtetërore	MFPT
24	Ligjit për Zyrtarët Publik dhe përdorimit të SIMBNJ-së pas përshtatjes së tij me ligjin e ri	Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik - DMZP



5.6.4. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e ARH-së

ARH ka bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare për transportin hekurudhor, bashkëpunim ky i filluar tash e sa vite, por i cili ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023.

5.6.4.1. Traktati i Komunitetit të Transportit - TCT

Kosova që nga viti 2018 kur edhe është miratuar Ligji për Ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit Nr. 06/L-109, ka hyrë në obligime që rrjedhin nga ky traktat. Një sistem hekurudhor i sigurt, gjithëpërfshirës, i besueshëm, i qëndrueshëm mjedisor dhe shoqëror dhe i ndërlidhur brenda rajonit dhe me BE-në, është qëllimi kryesor i Komunitetit të Transportit. ARH, përgjegjëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të hekurudhave është njëra nga institucionet që duhet të përmbush pjesën dërmuese nga këto obligime në fushën e hekurudhave, kryesisht në hartimin e legjislacionit sekondar për hekurudhat e Kosovës. ARH mbetet e përkushtuar maksimalisht ndaj përgjegjësisë së traktatit, duke e dëshmuar këtë edhe me përgatitjen dhe miratimin e shume akteve legjislative që derivojnë nga ky Traktat.

Komiteti Teknik për Hekurudhat, i krijuar nga Sekretariati i Komunitetit të Transportit, si një organ përkatës për të gjitha çështjet hekurudhore, bazuar në të dhënat e mbledhura për legjislacionin hekurudhor në rajon, përfshirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ka përgatitur Planin Hekurudhor të Veprimit që mbulon periudhën 2020-2023. Ky plan veprimi jep një pasqyrë të plotë të nivelit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar hekurudhor me acquis të BE-së.

ARH vazhdimisht ka kontribuar në ofrimin dhe sigurimin e këtyre të dhënave të paraqitura në planin hekurudhor të veprimit, kurdoherë që është kërkuar, qoftë përmes kërkesave zyrtare ose përmes takimeve që janë organizuar nga Sekretariati.

Edhe gjatë vitit 2023, si ARH kemi pasur bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Sekretariatit Permanent të Komunitetit të Transportit, bashkërisht kemi identifikuar sfidat dhe prioritetet që kemi para vetes në avancim dhe zhvillim të sektorit hekurudhor.

5.6.4.2. Bashkëpunimi me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudha - ERA

Bashkëpunimi ARH – ERA është një historik disa vjeçar bashkëpunimi dhe koordinimi nga fusha e Sigurisë dhe Interoperabilitetit hekurudhor. ARH në kuadër të këtij bashkëpunimi, respektivisht me ftesë/thirrje të ERA-së, edhe gjatë vitit 2023, ka qenë pjesëmarrëse në takimet, punëtoritë, konferencat që janë organizuar nga Agjencioni i Bashkimit Evropian i Hekurudhave për vendet përfituese të IPA-së. Disa nga këto evente janë mbajtur edhe nga distanca /online.

Si rezultat i bashkëpunimeve të lartëcekura, në vijim paraqesim eventet kryesore në të cilat zyrtarët përgjegjës nga ARH ishin pjesëmarrës:

Samitin e Ekselencës Hekurudhore të Ballkanit Perëndimorë

Traktati i Komuniteti të Transportit me datën 21.02.2023 në Prishtinë ka organizuar Samitin e Ekselencës Hekurudhore të Ballkanit Perëndimorë, i cili shërbeu si një platformë për diskutim mbi sfidat dhe zgjidhjet e identifikuara në sektorin hekurudhor. Përveç diskutimeve, u shkëmbyen njohuri, promovime dhe shkëmbime të ekspertizave ndërmjet vendimmarrësve të ndryshëm të transportit dhe shoqërisë civile. Në këtë samit u theksua edhe nevoja për të krijuar sa më shumë mundësi punësimi dhe për të tërhequr të rinjtë në kompanitë dhe administratat hekurudhore, duke sjellë ekspertë hekurudhor, nga universitete dhe përfaqësues të qeverisë për të diskutuar këto çështje, talentin në rajon dhe të nxisim inovacionin dhe zhvillimin teknologjik/digjitalizimin në sektorin hekurudhor.



Foto 1. Samitin e Ekselencës Hekurudhore të Ballkanit Perëndimorë

Punëtori -modeli i teknologjisë më të fundit të lidhjes automatike dixhitale (DAC)

Më datën:14.09.2023 me ftesë dhe organizim të Sekretariatit të Përhershëm të Komunitetit të Transportit – TCT, kemi marre pjesë në punëtorin një ditore në Beograd ku edhe u prezantua modeli i teknologjisë më të fundit të lidhjes automatike dixhitale (DAC), në të cilin ishin të pranishëm kompani hekurudhore, udhëheqës të industrisë hekurudhore dhe palë të interesit nga Ballkani Perëndimor.



Foto 2. Punëtori -Lidhje Automatike Dixhitale DAC

Demonstrimi i Lidhjes Automatike Dixhitale DAC kishte për qëllim të dëshmonte ndikimin e saj në rritjen e kapacitetit produktivitetit dhe efikasitetit të transportit hekurudhor të mallrave. Ai do ta bëjë transportin e mallrave me hekurudhë më të shpejtë, më të lirë, më të sigurt dhe në përgjithësi më efikas dhe konkurrues.

Punëtori mbi rregullimin ekonomik të transportit



Foto 3. Punëtori mbi rregullimin ekonomik të transportit

Me ftesë të Autoritetit Rregullator të Transportit -ART në Itali (Torino), me rastin e 10 vjetorit të themelimit të këtij institucioni, me datë 15.11.2023 kemi marre pjesë në punëtorinë i cila si temë kishte tendencat e fundit dhe perspektiva e pavarur në rregullimin ekonomik të transportit

Misioni i ekspertëve TAIEX në përgatitje për transpozim të Specifikacioneve për mjete lëvizëse

Me mbështetjen e Komisionit Evropian në Kosovë, përmes misionit të ekspertëve (BE) TAIEX organizuar në bashkëpunim me Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH) nga data 04 - 06



Foto 4. Misioni i ekspertëve TAIEX në përgatitje për transpozim të Specifikacioneve për mjete lëvizëse

korrik 2023, është mbajtur punëtori tre (3) ditore për transpozimin e Specifikimeve për mjete lëvizëse.

Qëllimi i misionit të ekspertëve ishte të ofrojë këshilla dhe udhëzime në harmonizimin e legjislacionit të interoperabilitetit hekurudhor në përputhje me ligjin dhe praktikën e BE-së. Ekspertët e BE-së nga Franca, (këshilltar i lartë për Interoperabilitet

SNCF - French Railways Holding dhe ekspert privat i pensionuar nga SNCF) mbështetur nga TAIEX ndanë ekspertizën dhe përvojën e tyre për të mbështetur hartimin e rregullores për regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse në Kosovë dhe plotësim/ ndryshimin e rregullores NVR nr. 05/2012. Përgjatë tre (3) ditëve janë prezantuar praktikën me të mira të BE-së lidhur me Regjistrin e mjeteve hekurudhore në modalitetin digjital (NVR, EVR, ECVVR). Vlen të theksohet se përveç ARH, pjesëmarrës ishin përfaqësues nga të gjitha palët e interesit.

Misioni i ekspertëve TAIEX lidhur me procesin e vendosjes në shërbim të linjës 10 në përputhje me specifikimet teknike për interoperabilitetin –STI

Nën organizimin ARH-TAIEX nga data 15 deri 18 maj 2023 është mbajtur punëtori katër ditore me ekspertët e BE-së, përmes TAIEX, përkatësisht nga Rregullatori i Hekurudhave dhe Organet Njoftuese në Itali. Qëllimi i kësaj punëtorie ka qenë njohja e procedurave për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturore në përputhje me specifikimet teknike të interoperabilitetit-STI. Ekspertët përmes kësaj punëtorie kanë prezantuar praktikën të cilat përdoren në bashkimin evropian, konkretisht në shtetin e tyre në Itali në lidhje me procedurat për autorizim për futje në shërbim të nënsistemeve strukturore në përputhje me specifikimet teknike të interoperabilitetit-STI.



Foto 5. Misioni ekspertëve TAIEX lidhur me procesin e vendosjes në shërbim të linjës 10 në përputhje me specifikimet teknike për inteoperabilitet - STI

Gjatë kësaj punëtorie katër ditore të mbajtur në ARH, përpos ARH-së, ka pasur pjesëmarrës nga ndërmarrjet/operatorët hekurudhor respektivisht përfaqësues nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos, përfaqësues nga Operatori Publik i Trenave Trainkos dhe përfaqësues nga Operatori Privat Railtrans.

Asambleja Plenare e 23-24 Majit 2023 IRG-Rail

Asambleja Plenare përbëhet nga të gjithë anëtarët e përfaqësuar nga shtetet anëtare të IRG-Rail, që shërben si forum për diskutimin dhe monitorimin e aktiviteteve të IRG-Rail dhe merr të gjitha vendimet që synojnë të ndjekin objektivat e IRG-Rail; miraton dokumentet; miraton çdo ndryshim të Memorandumit të Mirëkuptimit; miraton dhe ndryshon rregullat e punës dhe/ose marrëveshjet e punës; emëron Kryesuesin e saj; dhe krijon grupet e punës dhe emëron kryetarët e grupeve të punës. Asambleja Plenare e IRG-Rail u takua për sesionin e saj pranveror në Bonn, me 23-24 Maj



Foto 6. Asambleja Plenare e 23/24 Maj IRG-Rail

2023 i kryesuar nga Autoriteti Rregullator i Gjermanisë për Energjinë Elektrike, Gazin,

Telekomunikacionin nën përfaqësimin e 22 organeve rregullatore dhe 8 të lidhura në distancë.

Përveç raporteve nga Grupet e Punës për realizimin e programit

të punës 2023 dhe aktiviteteve të ardhshme të planifikuara, anëtarët e IRG-Rail trajtuan zhvillimet aktuale në sektorin hekurudhor dhe brenda IRG-Rail. Plenari miratoi dokumentet: Pikëpamjet e IRG Rail mbi iniciativën e Komisionit Evropian për të menaxhuar dhe koordinuar më mirë kapacitetin hekurudhor evropian dhe menaxhimin e trafikut; Udhëzime Përshkrimi i objekteve të shërbimit; Përditësimi i tabelës për afatet kohore të përcaktuara për përgjigjen e kërkesave për kapacitete sipas Art. 9 (1) të Rregullores Zbatuese (BE) 2017/2177 për aksesin në objektet e shërbimit dhe objektet e shërbimit hekurudhor.

Përpara Asamblesë Plenare, u miratua me procedurë elektronike votimi Raporti i 11-të Vjetor i Monitorimit të Tregut.

Asambleja Plenare e 28/29 Nëntorit IRG-Rail

Asambleja e radhës Plenare e RG Rail u mbajt në Berlin më 28/29 nëntor 2023, në te cilën morën pjesë edhe përfaqësuesit nga ARH. Përveç raporteve nga Grupet e Punës për dërgesat e tyre për vitin 2023 dhe aktiviteteve të ardhshme të planifikuara për programin e punës në vitin 2024, anëtarët e IRG-Rail trajtuan zhvillimet aktuale në sektorin hekurudhor dhe brenda IRG-Rail. Plenari miratoi



Foto 7. Asambleja Plenare e 28/29 Nëntorit IRG-Rail

dokumentet:

“Përditësim i dokumentit mbi qasjen ekonomike të parimeve të tarifimit të nenit 31 (7) dhe nenit 31 (8) të Direktivës 2012/34/BE”, raportin mbi “Rregullimin e tregut hekurudhor në терминаlet e mallrave”. Ai jep një pasqyrë të qasjeve kombëtare dhe konsideratave

se cilat pjesë dhe shërbime brenda një terminali mallrash janë të lidhura me hekurudhat dhe Memorandumi i Mirëkuptimit Art. 9 lit. 1 u ndryshua për t'u dhënë dy organeve rregullatore mundësinë për të bashkëkryesuar IRG-Rail.

Misioni i ekspertëve TAIEX për alokimin e infrastrukturës hekurudhore

Nën organizimin ARH-TAIEX nga data 31 janar-2shkurt 2023 është mbajtur punëtori tre ditore me ekspertët e BE-së, përmes TAIEX për alokimin e infrastrukturës hekurudhore. Qëllimi i misionit të ekspertëve ISHTE të ofrojë këshilla dhe udhëzime për ARH-në në transpozimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2016/545. Ekspertët nga Italia, Franca dhe Lituania do të ndajnë ekspertizën dhe përvojën e tyre mbi legjislacionin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër për alokimin e kapaciteteve hekurudhore. Ekspertët ofruan shpjegime detajuar mbi zbatimin në Itali, Lituani dhe Francë në lidhje me shpërndarjen e kapaciteteve dhe marrëveshjet kuadër të kontraktimit ndërmjet ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherëve të infrastrukturës.

U zhvillua punë e përbashkët në draft rregulloren për marrëveshjen kornizë e draftuar nga ARH me diskutim interaktiv të përfaqësuesve të palëve kryesore: ARH, Ministria e Infrastrukturaes, Trainkos, Infrakos dhe Railtrans. Gjithashtu është realizuar edhe vizitë në terren në zyrën e Trainkos, Infrakos dhe Railtrans në Fushë Kosovë për të prezantuar pjesën praktike të ndarjes së kapaciteteve, hartimin e marrëveshjes kornizë. Diskutimi u shtri edhe në kornizën hekurudhore në Kosovë.



Foto 8. Misioni i ekspertëve TAIEX për alokimin e infrastrukturës hekurudhore

IPA Vizitë Studimore në lidhje me lëndët djegëse alternative për hekurudhat (qelizat e karburantit me hidrogjen) dhe trenat elektrikë me bateri

Me ftesë të IPA-së në datat 10-12 tetor 2023, ARH ishte pjesëmarrëse në vizitën studimore të IPA-së (IPA Study Visit related to alternative fuels for railways (hydrogen fuel cells) and battery electric trains) lidhur me lëndët djegëse alternative për hekurudhat (qelizat e karburantit me hidrogjen) dhe trenat elektrikë me bateri në Gjermani përkatësisht në zonat e Bremenit dhe Düsseldorf.



Foto 9. Vizitë Studimore në lidhje me lëndët djegëse alternative për hekurudhat

ERA - Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudhat dhe Shoqata e Industrisë Evropiane të Furnizimit Hekurudhor - UNIFE, me pjesëmarrjen e Komunitetit të Transportit (TCT), organizuan një vizitë studimore për ekspertët e hekurudhave nga Ballkani Perëndimor, Republika e Moldavisë dhe Turqia, duke u fokusuar në lëndët djegëse alternative për hekurudhat. Gjithashtu vizituam teknologjitë më të


fundit në qendrat e njohura të kërkimit dhe zhvillimit gjatë vizitës studimor. Kjo përvojë na lejoi të kuptojmë avantazhet dhe sfidat e këtyre teknologjive inovative dhe potencialin e tyre për të riformuar peizazhin e transportit hekurudhor.

Takim i 62 - 63 dhe 64 i rrjetit të NSA të BE-së

Gjatë vitit 2023 përfituesit e projektit IPA janë ftuar të marrin pjesë si vëzhgues takimin të 62-të të Rrjetit NSA më dt.: 14 mars 2023, ndërsa me dt.: 10-11/05/2023 në Takimin 63-të. Gjithashtu me dt.: 7-8/11/2023 në takimin e 64-të të Rrjetit të Autoriteteve Nacionale për Siguri Hekurudhore (NSA) të shteteve anëtare të BE-së. ARH ka marrë pjesë me dy ekspert në cilësi të vëzhguesve në këto takime të cilat janë organizuar përmes platformave online.



Lidhur me procesin e licencimit të makinistëve me datën 23.02.2023 në Prishtinë është zhvilluar edhe një punëtori një ditore e organizuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudhat – ERA, me temën Trajnimi dhe Licencimi i Makinistëve, ku ishin të pranishëm pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërsa prezantuan ekspert të fushës së hekurudhave nga Agjencia Evropiane e Hekurudhave ERA. Qëllimi i kësaj punëtorie rajonale ishte të ofrojë këshilla se si të harmonizohet trajnimi dhe licencimi i makinistëve të trenit në vendet e rajonit, si të tërheqim talentet e ri në hekurudha, STI OPE dhe kërkesat për personelin tjetër nga makinistët e trenave e që kryejnë detyra kritike për sigurinë, perspektiva për të ardhmen - çfarë do të duhej të ndryshon më një rishikim të Direktivës së makinistëve dhe të tjera.





5.7. Asetet

5.7.1. Asetet në posedim të institucionit

ARH-ja ka në përdorim 389 asete me vlerë fillestare në blerje prej 133,960.49 euro. Këto aset janë kryesisht orendi zyrash dhe pajisje teknologjike. Zhvlerësimi i aseteve bëhet çdo fund vit sipas dispozitave të Rregullores MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe sipas udhëzimit nr. 01/2012 për menaxhimin e pasurisë.

Zhvlerësimi i aseteve në ARH është kryer për asetet mbi 1,000.00 € dhe nën 1,000.00 €. Sipas raporteve vlera e aseteve me vlerë mbi 1,000.00 € është 204.91 €, ndërsa vlera e aseteve me vlerë nën 1,000.00 € për vitin 2023 sipas rregullave të parapara me rregulloren e lartcekur është 4,158.40 €.

5.7.2. Planet për asete të reja

Ka qenë dhe vazhdon të jetë kërkesë e ARH-së sigurimi i zyrave në hapsirat e objekteve publike të destinuara për zyra, me qëllim të evitimit të pagesës së qirasë. Pavarësisht disa kërkesave të ARH-së drejtuar MAP-it, akoma kjo çështje nuk është zgjidhur dhe vazhdon të jetë ngarkesë buxhetore për institucionin.

Zyrat e ARH-së janë në Prishtinë në Rr. “Rrustem Statovci” nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 400 m².

Investim tjetër i nevojshëm është edhe furnizimi me pajisje të tjera, me inventar për zyre dhe mjete tjera për nevoja të ARH-së.

6. Përshkrimi i fushës që e mbulon ARH

6.1. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin e BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH, me punën dhe vendimet e saj, ofron transparencë dhe jo diskriminim për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor.

Ndërsa, nga aspekti i angazhimeve në pasurimin e infrastrukturës ligjore, ARH ka miratuar rregullore të nevojshme, të cilat i kemi listuar te pika 3.2. e këtij raporti.



6.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2023

Plani i Punës shërben për koordinimin e aktiviteteve të ARH-së dhe departamenteve përkatëse të tij, në mënyrë që të mundësohet përmbushja e fakteve dhe me kohë e synimeve dhe objektivave të përcaktuara. Plani i punës hartohet në atë formë duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore për përmbushjen e obligimeve ligjore, të cilat hartohen në nivel të menaxhmentit. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë në konsistencë me misionin dhe përgjegjësitë e ARH-së të përcaktuara me LH.

Tabela 3. Planifiki i punës për vitin 2023 dhe realizimi

Realizimi i Planit të Punës për vitin 2023						
Aktivitetet e planifikuara		Periudha				Përfunduar
						Në Proces
		K	K	K	K	Statusi
		I	II	III	IV	Pa Përfunduar
1	Nxjerrja e akteve nënligjore të planifikuara në bazë të agjendës të paraparë në PKIE dhe Traktatin e Transportit, që derivojnë nga Ligji i Hekurudhave dhe që transpozojnë legjislacionin e BE-së.	x	x	x	x	E realizuar (Grupet punuese kanë finalizuar draftet e Rregulloreve, në mungesë të Bordit të ARH nuk është miratuar)
2	Përgatitja e Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet dhe dokumentacionin përcjellës, duke siguruar që korniza legjislative nacionale dhe standardet për Interoperabilitet të jenë të harmonizuara dhe përditësuara në përputhje me legjislacionin (acquis) e sektorit hekurudhor të BE-së, të përshtatshme për Kosovën (STI në lidhje me nënsistemin "aplikacione telematike për shërbimet e mallrave" STI TAF).				X	Në proces (Grupi punues ka finalizuar draftin e Rregullores, në mungesë të Bordit të ARH nuk është miratuar)
3	Përgatitja e Planit të Performances të ARH për vitin 2024				x	E realizuar
4	Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore në bazë të LMFP-së	x				E realizuar
5	Përditësimi i regjistrit NVR				x	E realizuar
6	Shqyrtimi i aplikacioneve për licenca të makinistëve	x	x	x	x	E realizuar
7	Inspektimi i makinistëve të licencuar dhe përgatitja e raporteve të inspektimit të makinistëve	x	x	x	x	E realizuar



8	Rregullat Nacionale të Sigurisë	x	x	x	x	Në proces : ARH ka ndërmarr veprime konkrete në procesin e hartimit të Rregullave Nacionale të Sigurisë. Sipas LH i ka përcjell në MMPHI për miratim.
9	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe infrastruktura hekurudhore gjatë vitit 2022	x	x	x	x	E realizuar
10	Shqyrtimin e ankesave/komentet për tregun hekurudhor në transportin e mallrave si dhe për të drejtat e udhëtareve			x	x	Gjate vitit 2023 nuk kemi pranuar asnjë ankesë në lidhje me tregun hekurudhor
11	Shqyrtimi i aplikacioneve për Autorizim të Sigurisë, Certifikatë të Sigurisë dhe për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse			x		E realizuar
12	Raportimet në lidhje me përmbushjen e obligimeve ligjore/institucionale nga ARH në agjendën Evropiane, konkretisht obligimeve që derivojnë nga MSA-ja dhe Traktati i Komunitetit të Transportit, mbështetur me raportime të rregullta në institucionet qendrore.	x	x	x	x	E realizuar
13	Monitorimi i Marrëveshjes mbi qasjen në binar në mes të Menaxherit të infrastrukturës dhe operatorëve hekurudhor.	x	x	x	x	E realizuar
14	Përgatitja e barazimeve mujore dhe vjetore si dhe përgatitja dhe dorëzimi i Qarkoreve Buxhetore	x	x	x	x	E realizuar
15	Realizimi i Planifikimit të Prokurimit sipas nevojave të ARH-së	x	x	x	x	E realizuar
16	Azhurnimi i Regjistrat të Makinistëve të Licencuar	x	x	x	x	E realizuar
17	Përfaqësimet e ARH-së në gjykata vendore në çështjet ligjore që ndërlidhen me institucionin dhe sektorin e hekurudhave, në rastet në të cilat ARH mund të jetë potencialisht e përfshirë	x	x	x	x	E Realizuar
18	Monitorimi i tregut hekurudhor në Kosovë, dhe përgatitjen e raportit të monitorimit të tregut	x	x	x	x	E realizuar
19	Sigurimin se pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës të janë transparente dhe jo diskriminuese	x	x	x	x	E realizuar
20	Përgatitja e Raportit të Sigurisë, i cili pasqyron zhvillimet e sigurisë hekurudhore, duke përfshirë informacion të përgjithshëm dhe specifik për nivelin e sigurisë në hekurudha, statistika për aksidente dhe incidente, ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativë në lidhje me sigurinë hekurudhore dhe informacione të tjera të rëndësishme, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Hekurudha.			x		E realizuar



21	Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për Qasje në Dokumente Publike.	x	x	x	x	Nuk kemi pasur asnjë kërkesë për qasje në dokumente publike.
22	Monitorimi i validitetit të të gjitha licencave të lëshuar nga ARH në sektorin hekurudhor, për te siguruar në vazhdimësi përmbushjen e kushteve ligjore, përfshirë monitorimin e Sigurimeve për palët e treta të kompanive hekurudhore të licencuara.	x	x	x	x	E realizuar
23	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga Raporti i inspektimit NVR 2022	x	x	x	x	E realizuar
24	Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore në aspektin e sigurisë në menaxhim të Infrakos		x	x	x	E realizuar
25	Inspektimi i mjeteve lëvizëse në aspektin e sigurisë në menaxhim të Infrakos, Trainkos, Rail Trans dhe Feronikel		x	x	x	E realizuar
26	Inspektimi i regjistrat të mjeteve lëvizëse NVR, EVN dhe VKM në menaxhim të Infrakos, Trainkos, Rail Trans dhe Feronikel				x	E realizuar
27	Fushat vetedijesuese për të drejtat e udhëtarëve			x		E realizuar

6.2.1. Plani i performances së ARH për vitin 2024

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave bazuar në obligimet ligjore të dala nga Ligji Nr.06/-113 Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavaruara, neni 43 pika 3 ka përgatitur dhe dorëzuar në afatet ligjore planin e performancës për vitin 2024 në Kuvendin e Kosovës, pranë Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim.

Dokumenti është hartuar duke ju përmbajtur udhëzimeve të Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore për hartim të këtij dokumenti.

Plani i Performances i ARH, paraqet një pasqyrë të objektivave dhe aktiviteteve që janë paraparë që të zhvillohen përgjatë vitit 2024, gjithnjë duke synuar performancë sa më efikase në ofrim të shërbimeve dhe realizim konkret të planit. Planifikimi i objektivave është bazuar në planin strategjik të ARH-së, LH dhe Traktatin e Komunitetit të Transportit.

Në mungesë të Bordit të ARH, Plani i Performances 2024 nuk është mbrojtur pranë Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, ashtu siç e kërkon korniza ligjore në fuqi, përkundër faktit se i njëjti nga ana e ARH ishte përgatitur dhe dorëzuar në kohë.



6.3. Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit

- Miratimi i rregulloreve të reja dhe ndryshim/plotësimi i atyre ekzistuese;
- Monitorimi dhe rregullimi i tregut hekurudhor, përfshirë mbikëqyrjen e konkurrencës në transportin hekurudhor;
- Avancimi në aspektet e sigurisë hekurudhore, përmes inspektimeve dhe dhënies së rekomandimeve;
- Shqyrtimi i aplikacioneve të reja për licencim të makinistëve, si dhe monitorimi i atyre ekzistuese.

6.4. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues

- Implementimi i Paketës së 4 Hekurudhore;
- Përgatitja dhe implementimi i Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet;
- Mbikëqyrja e procesit të përgatitjes profesionale të makinistëve;
- Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore nga ana e ARH-së dhe MMPHI-së, në harmoni me legjislacionin e BE-së;
- Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës;
- Përgatitja e Rregullave Nacionale të Sigurisë.

7. Puna gjatë vitit raportues

Aktivitetet dhe të arriturat gjatë vitit raportues 2023, janë të përshkruara më poshtë, të përmbledhura sipas fushë-veprimtarisë së ARH-së, dhe atë: në aktivitetet legjislative, aktivitetet për përmbushjen e obligimeve nga agjenda e integritetit evropian, përfaqësimet ligjore, inspektimet, monitorimet, Ekspozeu i Rrjetit, aplikimet, azhurnimi i regjistrave, aktivitetet për rritjen e sigurisë hekurudhore, punët administrative, aktivitetet që lidhen me fushën e financave, ato të prokurimit, etj.

Për secilën nga këto është dhënë nga një përmbledhje e aktiviteteve kryesore të cilat vlerësohet se janë në interes të pasqyrimit të saktë të punës së ARH-së.



7.1. Aktivitetet legislative të ARH-së

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ARH ka përgjegjësi në hartimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore, në të gjitha fushat profesionale që i mbulon, siç janë: Licencim, Siguri, Rregullim i Tregut dhe Interoperabilitet. Për vitin 2023, ARH kishte planifikuar në programin e punës së saj hartimin dhe miratimin e katër akteve nënligjore në fushën e Interoperabilitetit, Rregullimit të Tregut dhe Sigurisë, e të cilat janë finalizuar si draft nga grupet punuese të ARH-së, mirëpo nuk janë miratuar pasi që Bordi i Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave që nga data: 21.07.2021, është shkarkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me Vendim Nr.08-V-040, i cili sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës është përgjegjës për miratimin e këtyre akteve nënligjore të ARH-se.

Projekt rregulloret të finalizuara nga ARH gjatë vitit 2023, përveç se bazohen në kërkesat dhe nevojat e sektorit hekurudhor, të njëjtat derivojnë edhe nga Traktati i Komunitetit të Transportit, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, e të cilat janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me procesin e integriteteve Evropiane. Si rrjedhojë, miratimi i këtyre projekt rregulloreve nga fushat e lartcekura, do të ketë efekt pozitiv të drejtpërdrejtë në indikatorët matës që BE-ja ju bënë institucioneve të Republikës së Kosovës, në raport me obligimet që rrjedhin nga MSA-ja.

ARH-ja, në grupet punuese për hartimin e këtyre akteve nënligjore, përveç stafit të brendshëm në secilin grup punues ka ftuar dhe përfshirë edhe palët e interesit, si Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore -Infrakos, Operatorët Hekurudhore Trainkos dhe Railtrans. Për më tepër që të gjitha janë mbështetur edhe me Ekspertë të BE-së përmes TAIEX-it.

Gjatë vitit 2023, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ka planifikuar dhe hartuar Projekt Rregulloret si më mëposhtë:

- **Projekt Rregullore Nr. XX/2023** për "Procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kornizë për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore" (kjo projekt rregullore transponon rregullore të Komisionit për Zbatim (BE) 2016/545 e datës 7 Prill 2016 mbi procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kuadër për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, OJ BE L 94, 8.4.2016, f. 1), e planifikuar për miratim në K3 2023;
- **Projekt Rregullore Nr. XX/2023** për Specifikacionet teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin "aplikacionet telematike për mallra"- STI TAF.(Kjo projekt rregullore adopton Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1305/2014 e datës 11 dhjetor 2014.) e planifikuar për miratim në K4 2023;
- **Projekt Plotësim/Ndryshim i Rregullores Nr. 05/2012** për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse.(Ky plotësim ndryshim adopton Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2018/1614 i datës 25 tetor 2018), e planifikuar për miratim në K4 2023;

- **Projekt Rregullore Nr. XX/2023** për Kryqëzimet hekurudhë- rrugë, ref. nga Direktiva e Komisionit 2014/88/BE e datës 9 korrik 2014 që ndryshon Direktivën 2004/49/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me treguesit e përbashkët të sigurisë dhe metodat e zakonshme të llogaritjes së kostove të aksidenteve, (Level crossings - European Union common safety indicators (ref. Commission Directive 2014/88/EU of 9 July 2014 amending Directive 2004/49/EC of the European Parliament and of the Council as regards common safety indicators and common methods of calculating accident costs), e planifikuar për miratim në K4 2023;

7.2. Përmbyllja e obligimeve nga agjenda për Integritetin Evropian lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar për Integritet Evropian (PKIE)

Përveçse obligimeve ligjore që derivojnë nga Ligji i Hekurudhave, i cili shprehimisht i obligon institucionet e Republikës së Kosovës, që të marrin për bazë legjislacionin Evropian respektivisht *acquis* e BE-se në fushën e Hekurudhave, ndër vite ka qenë dhe akoma vazhdon të jetë kërkesë e vazhdueshme edhe e BE-së, e shprehur në raportet e progresit, dhe jo vetëm, që Kosova gradualisht të adaptoj dhe harmonizoj rregullat teknike për përmbylljen e kërkesave për Siguri dhe Interoperabilitet.

Në baza vjetore, në procesin e raportimeve në lidhje me përmbylljen e obligimeve që derivojnë nga MSA, ARH me dt:23.03.2023, ashtu sikurse të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës, raportoi para Komisionit Evropian/Nënkomitetit për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal mbi të arriturat/rezultatet e përmbylljes së detyrimeve të saj në raport me rekomandimet e Raportit të Progresit për Kosovën në seksionin e Politikës së Transportit.




Foto 12. Takimi i Nen Komitetit Infra mbajtur virtualisht me përfaqësuesit e Komisionit Evropianë në Bruksel.



Vlen të përmendim edhe konkluzionet e dala pas takimit të mbajtur virtualisht në Bruksel me datën 23.03.2023, në të cilën përmendet vazhdimi i transpozimit të acquisit të BE-së në tregun hekurudhore, respektivisht harmonizimi i Ligjit të Hekurudhave me Direktivën e BE 2012/34 të ndryshuar me Direktivën 2016/2370 (BE), si dhe transpozimi i Direktivave të reja për Siguri dhe Interoperabiliteti 2016/797 (BE) dhe 2016/798 (BE).

Për vitin 2023, ARH ka pas të planifikuara hartimin dhe miratimin e katër rregulloreve të cilat drejtpërsëdrejti transpozojnë direktivat e BE-së në fushën hekurudhore të interoperabilitetit, Rregullimit të Tregut dhe Sigurisë, e të cilat fatkeqësisht nuk janë miratuar në mungesë të bordit të ARH-se si organ përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore. Po ashtu, ARH ka qenë gjatë gjithë kohës në kontakt me akterët relevant në planifikimin, përgatitjen dhe raportimin e përmbushjes së obligimeve të veta legjislative për vitin 2023, të cilat kanë qenë të paraqitura edhe në PKIE, si dhe departamentit për Integritet Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe ajo e Infrastrukturës dhe Transportit. Në vazhdimësi kemi përditësuar edhe inputet për të gjitha zhvillimet në sektorin hekurudhor, për secilin kuartal veç e veç për vitin 2023, të cilat përmes Departamentit për Integritet Evropian në ZKM, janë raportuar edhe në Komisionin Evropian.

8. Përfaqësimet Ligjore

Gjatë vitit 2023 përfaqësuesit ligjorë të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave kanë marrë pjesë në disa konteste gjyqësore në të cilat ARH ishte në cilësinë e palës së paditur dhe si palë me interes.

8.1. Inspektimet

8.1.1. Inspektimi i makinistëve

Sipas Ligjit të Hekurudhave ARH ka të drejtë të inspektoj makinistët të cilët drejtojnë trena në linjat hekurudhore funksionale brenda për brenda territorit të Republikës së Kosovës. Po ashtu, në planin e punës dhe aktiviteteve kanë qenë të parapara që të bëhen inspektime të makinistëve, sipas nevojës dhe vlerësimit institucional. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2023 ARH ka realizuar inspektim të makinistëve, në linjën hekurudhore Prishtinë-Pejë, dhe nuk ka kryer inspektime në linjën hekurudhore Hani i Elezit – Prishtinë për arsye të punimeve që janë duke u zhvilluar në këtë linjë. Qëllimi i këtyre inspektimeve është verifikimi, nëse trenat në Kosovë drejtohen vetëm nga makinistët e licencuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave respektivisht organi i licencimit. Vlen të theksohet, se që nga licencimi i parë i makinistëve i bërë nga ARH-ja në vitin 2015, nga të gjitha inspektimet në terren, përfshirë edhe ato të realizuara gjatë vitit 2023, ka rezultuar se trenat drejtohen vetëm nga makinist të licencuar.



8.1.2. Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore

ARH në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore të parapara me LH, neni 19 paragrafi 6, 104 paragrafi 5, si dhe në përputhje me planin e punës për vitin 2023, ka kryer inspektimin e të gjitha linjave hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it. Gjatë procesit të inspektimit janë marrë parasysh të gjithë faktorët të cilët direkt apo indirekt kanë ndikim në sigurinë hekurudhore. Për secilën linjë të inspektuar është përgatitur një raport me të gjeturat kryesore gjatë inspektimit. Në raport janë përfshirë disa nga të gjeturat për të cilat ne kemi vlerësuar se janë me të rëndësishme. Gjatë inspektimeve të realizuara përgjatë vitit 2023, kryesisht jemi fokusuar në inspektimin e vendkalimeve hekurudhore në nivel, pasi që këto segmente janë identifikuar si pikat më të ndjeshme në aspektin e sigurisë, duke i përfshirë pothuajse të gjitha aksidentet dhe incidentet hekurudhore.

Linjat e inspektuara janë:

1. Prishtinë-Fushë Kosovë,
2. Klinë-Prizren,
3. Prishtinë-Podujevë,
4. Fushë Kosovë-Mitrovicë,
5. Fushë Kosovë-Pejë,
6. Fushë Kosovë-Hani i Elezit,
7. Bardh-Medvec.

Në raportet e përgatitura kemi paraqitur mangësitë të cilat ekzistojnë në secilën linjë veç e veç, por kemi evidentuar edhe punët/veprimet të cilat janë kryer nga ana e kompanisë Infrakos. Gjatë inspektimit të linjave kemi konstatuar se është punuar në mirëmbajtjen e gjeometrisë së linjave, balastit, ndërruesve dhe traversave. Shqetësuese për ne mbetet sinjalizimi dhe siguri i vendkalimeve. Në këtë pjesë ne vlerësojmë që duhet të punohet më shumë. Shumë vendkalime shtrihen në vendbanime ku frekuentimi nga ana e banorëve dhe automjeteve është mjaft i madh. Në disa pjesë ka mungesë qoftë të sinjalizimit me shenja të komunikacionit rrugor, siguri me semafor apo barriera (rampë). ARH vlerëson se këto vendkalime janë pikat me të rrezikshme të identifikuar gjatë inspektimit.

8.1.3. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore

Gjatë vitit 2023, ARH ka kryer inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë në administrim apo pronësi të Infrakos-it, Trainkos-it, Railtrans-it dhe NewCo Ferronikel-it Complex LLC, të cilat janë të autorizuar për futje në shërbim nga ana e ARH-së/organi i sigurisë hekurudhore.

Janë inspektuar këta parametra të sigurisë: dimensionet e profilin të rrotave, trashësia e rrotave, papuçet e frenimit, sistemi i frenimit, hapja dhe mbyllja e dyerve, sistemi i ndriçimit, sistemi i zërimit/buria, sistemi i komunikimit/radio lidhjet, lidhëset e ajrit, çengeli etj.



Për të gjitha këto mjete lëvizëse hekurudhore është përgatitur nga një raport, ku kemi paraqitur të gjeturat gjatë procesit të inspektimit.

8.1.4. Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse NVR

Për të kontrolluar nëse mjetet lëvizëse hekurudhore me të cilat operojnë ndërmarrjet hekurudhore brenda territorit të Republikës së Kosovës janë të regjistruara, ashtu siç përcaktohen me Rregulloren e Regjistrimit nr. 05/2012, ARH bazuar në punën dhe përgjegjësitë e veta, në baza vjetore realizon inspektimin e Regjistrimit të Mjeteve Lëvizëse NVR.

Gjatë inspektimit NVR është realizuar edhe kontrollimi i shënimit të numrit identifikues unik dymbëdhjetë shifrore, i njohur si Numri Evropian i Mjetit Lëvizës EVN, i cili ligjërisht duhet të jetë i shënuar në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të vendosura në shërbim që janë pjesë e regjistrimit NVR. Përmes këtij numri identifikohet secili mjet lëvizës hekurudhor.

Përveç kësaj në mjetet lëvizëse duhet të bëhet e dukshme edhe kompania të cilës i përket. Kjo realizohet përmes shënimit të kodit VKM (Shënimit i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës), i cili është pasqyrim i emrit të plotë apo shkurtesës së mbajtësit/ndërmarrjes të mjetit lëvizës. Prandaj, pjesë e procesit të inspektimit 2023 ka qenë edhe VKM-ja, inspektim i realizuar njëkohësisht me inspektimin NVR.

Inspektimi NVR 2023 ka përfshirë mjetet lëvizëse të Trainkos-it, Infrakos-it, Railtrans-it dhe mjetet lëvizëse të New CoFerronikeli Complex LLC. Mbështetur nga të gjeturat e inspektimit në teren janë përgatitur raportet me rekomandime, të cilat janë dërguar në të gjitha kompanitë përkatëse. Departamenti përgjegjës për interoperabilitet në vazhdimësi mbikëqyrë edhe përmbushjen e rekomandimeve të dala nga inspektimet e viteve paraprake.

Tabela 4. Kompanitë hekurudhore të inspektuara (NVR, EVN dhe VKM)

Ndërmarrja	VKM	Shteti	Statusi			Webfaqja
			Bllokuar	Në përdorim	Revokuar	
INFRAKOS	IHK	KS	Në përdorim			www.infrakos.com
TRAINKOS	TRAINKOS	KS	Në përdorim			www.trainkos.com
RAILTRANS	RT	KS	Në përdorim			www.railtrans.biz
NEWCO FERRONIKELI COMPLEX LLC	NCF	KS	Në përdorim			www.cunicoresources.com



Ndërsa, me kërkesë të Infarkos-it të datës 18.11.2022 për largim të mjeteve lëvizëse të demoluara nga raporti NVR, bazuar në vlerësimin dhe konstatimin profesional që është bërë nga zyrtarët e INFRAKOS SH.A, të njëjtat janë larguar nga raporti i inspektimit të Regjistrisë Nacional - NVR.

9. Monitorimet

9.1. Monitorimi i licencave

Edhe gjatë vitit 2023, ARH ka monitoruar licencat e lëshuara ndër vite. Monitorimi i Licencës të Menaxherit së Infrastrukturës Hekurudhore – Infrakos SH A, dhe licencat për Operatoret Hekurudhore publik dhe privat Trainkos dhe Railtrans LLC, kryesisht ka qenë i përqendruar tek polica e sigurimit në raport me palët e treta, si mbulueshmërisë në rast të incidentit apo aksidentit hekurudhor brenda për brenda territorit të Republikës së Kosovës. Në vazhdimësi nëse si ARH kemi kërkuar që ky kusht të plotësohet pa ndërprerje, duke ju rikujtuar kohë pas kohe këtë detyrim ligjorë operatoreve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës hekurudhore, përkundër faktit se një gjë e tillë është në përgjegjësinë direkt të tyre.

Po ashtu, në kuadër të monitorimit të licencave të makinistëve të licencuar, hyjnë edhe raportet mjekësore periodike respektivisht ekzaminimet mjekësore të kryera nga institucionet shëndetësore kompetente, të cilat i kërkon ARH-ja. Bazuar në legjislacionin në Kosovë, respektivisht Ligjin e Hekurudhave të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2013 për Licencim të Makinistëve, makinistët mbi moshën 55 vjeçare, këto raporte mjekësore duhet t'i sjellin në baza të rregullta vjetore, ndërsa makinistët nën moshën e 55 vjeçare, një herë në tre vite. Edhe gjatë vitit 2023 ARH ka pranuar raportet mjekësore nga operatorët hekurudhore publik dhe privat për makinistët e tyre të licencuar, si dhe nga menaxheri i infrastrukturës hekurudhore për makinistët – manipuluesit me motorë të rëndë hekurudhorë.

9.2. Monitorimi i tregut hekurudhor

ARH, në kuadër të kompetencave ligjore, njëherë nga përgjegjësitë kryesore e ka monitorimin e tregut hekurudhor në vend, monitorimin e marrëveshjes mbi qasje në binar në mes të menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore. Në kuadër të kësaj përgjegjësie, ARH gjatë vitit 2023 ka monitoruar tregun hekurudhor në Republikën e Kosovës. Pas monitorimit është përgatitur raport i veçantë, ku në detaje janë paraqitur të dhënat e gjetura nga terreni dhe nga burime të ndryshme të informacionit prej entiteteve që merren me statistika dhe analiza të transportit në përgjithësi. Të gjeturat e raportit të monitorimit të tregut përveç se i shërbejnë ARH-së dhe sektorit hekurudhor brenda Kosovës, të njëjtat, përmes formatit elektronik raportohen në periudha vjetore edhe në Grupin e Rregullatorëve të Pavarur Evropian – IRG Rail, ku ARH që nga viti 2013 është anëtare me të drejtë të plota. Të dhënat e monitorimit të dërguara nga ARH, më pastaj përmbledhen dhe publikohen nga ky mekanizëm evropian, në një raport të veçantë ku përfshihen të dhënat e monitorimit të tregut hekurudhor për tërë Bashkimin Evropian dhe më gjerë.



Përmes procesit të monitorimit mundësohet mbledhja e sa më shumë të dhënave për tregun hekurudhor, në mënyrë që këto të dhëna t'i vë në shërbim të funksionimit më të mirë të sektorit hekurudhor. Monitorimi i tregut është një instrument dhe mekanizëm i rëndësishëm i cili mund të kontribuojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve në transportin hekurudhor. Po ashtu raporti i monitorimit të tregut mund të shërbejë si një dokument i rëndësishëm që paraqet zhvillimin e tregut hekurudhor në vend për të gjitha palët e interesit. Dokumenti në të cilin përcaktohen treguesit e monitorimit të tregut, është i të njëjtit format me atë të IRG-Rail, për monitorimin e tregut hekurudhor, i cili është i njëjti për të gjithë rregullatorët të cilët janë të anëtarësuar në këtë rrjet evropian.

9.3. Ekspozeu i Rrjetit

ARH gjatë vitit 2023, në kuadër të kompetencave ligjore ka kryer me sukses monitorimin e Ekspozeut të Rrjetit 2023 dhe fillimin e procesit të konsultimeve për draft Ekspozeun e Rrjetit 2024, ku ka bërë pranimin, shqyrtimin, analizimin, komentimin dhe ka dhënë rekomandimet për këtë draft, i cili është përgatitur nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore-Infrakos. Lidhur me këtë është mbikëqyrë procesi i konsultimeve mes palëve të interesit, siç janë: Infrakos, Trainkos, Railtrans, MMPHI, ME. Si temë specifike ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i Ekspozeut të Rrjetit me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës. ARH ka pranuar komente nga operatorët hekurudhor lidhur me lartësinë e tarifave të propozuara nga Menaxheri i Infrastrukturës. Pas shqyrtimit të komenteve dhe fakteve të paraqitura, ARH ka dhënë komentet në përputhje me LH në lidhje me lartësinë e çmimeve të propozuara dhe përshtatshmëria me kushtet e tregut në Kosovë si dhe krahasimin me vendet e rajonit.

MMPHI pavarësisht detyrimit ligjor, gjatë vitit 2023 nuk ka arritur të miratojë strukturën e sistemit të vendosjes së çmimit për shfrytëzuesit e rrjetit dhe nivelin e përgjithshëm të pagesave të shfrytëzimit të infrastrukturës hekurudhore, e përcaktuar në Ekspozeun e Rrjetit 2024.



10. Aplikime të reja

10.1. Licenca

Në janar të vitit 2023, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos SHA ka pranuar dhe rishqyrtuar njëmbëdhjetë (11) aplikacione për licencë të makinistëve – manipulues me mjete të rënda hekurudhore, dhe katër (4) aplikacione për licence makinisti nga operatori publik Trainkos, pra gjithsej në total pesëmbëdhjetë (15) aplikacione për licencë.

Këto aplikacione së bashku me dokumentacionin përcjellës, brenda afateve dhe kriterëve të papara ligjore, janë shqyrtuar nga ARH. Shqyrtimi i këtyre aplikacioneve nga ana e ARH-së është bërë komfor procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës si dhe Rregullores Nr.02/2013 për Licencimin e Makinistëve. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të lartpërmendur, ARH ka nxjerre vendim ku nga pesëmbëdhjetë (15) aplikacionet respektivisht kërkesat për licenca vetëm trembëdhjetë (13) i ka licencuar dhe dy (2) kërkesa të tjera i ka refuzuar.

Ndërsa sa i përket aplikimeve për licence për transport të udhëtareve apo mallrave nuk ka pasur ndonjë aplikacion gjatë vitit 2023, as nga kompanitë vendore apo ato ndërkombëtare. Bazuar në Ligji për Hekurudhat e Kosovës, tregu hekurudhor është i liberalizuar dhe se kompani të ndryshme të jashtme mund të aplikojnë për licencë të re apo njohje të saj. Vlen të ceket se njohja e licencës Evropiane sipas ligjit është kompetencë e Ministres së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

10.2. Shqyrtimi i aplikacioneve për marrjen e Autorizimit dhe Certifikatës së Sigurisë

Gjatë vitit 2023 respektivisht me datë 20.03.2023 Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore të Kosovës Infrakos Sh.A. ka aplikuar të Autoriteti Rregullativ Hekurudhave për të marrë një Autorizim të Sigurisë të rinovuar Pjesa A dhe B. Organi i Sigurisë ka analizuar aplikacionin konformë dispozitave ligjore në fuqi dhe me datë: 28.03.2023 ka vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe ka vendosur që të lëshojë Autorizim të Sigurisë të rinovuar Pjesa A dhe B.

Po ashtu, Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos Sh.A me datë: 14.03. 2023 ka aplikuar të Autoriteti Rregullativ Hekurudhave për të marrë një Certifikatë të Sigurisë të rinovuar pjesa A dhe B. Organi i Sigurisë ka analizuar aplikacionin konformë dispozitave ligjore në fuqi dhe me datë: 22.03.2023 ka vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe ka vendosur që të lëshojë Certifikatë të Sigurisë të rinovuar Pjesa A dhe B.



10.3. Shqyrtimi i aplikacioneve të mjeteve lëvizëse të kompanisë italiane Generale Costruzione Ferroviare - GCF për autorizim dhe regjistrim

Kompania italiane GCF - Generale Costruzioni Ferroviarie S.p.A, është e përzgjedhur për rehabilitimin e linjës së 10 hekurudhore për fazën e parë (Leshak-Hani i Elezit), dhe fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë) që aktualisht po zhvillon punimet në këtë linjë me qëllim të rehabilitimit të saj. Në vitin 2023 është shqyrtuar kërkesa për vazhdimin e njohjeve të Autorizimeve për Futjen në Shërbim të mjeteve lëvizëse në pronësi të kompanisë Italiane GCF (Generale Costruzioni Ferroviarie). Këto mjete levizese punuese do të përdoren për ndërtimin/rehabilitimin e linjës 10 (Hani Elezit - Fushë Kosovë - Mitrovicë).

Mjeteve lëvizëse punuese hekurudhore të cilave ju është vazhduar njohja e autorizimeve për futje në shërbim gjatë vitit 2023 kanë qenë gjithsej 32 mjete levizese punuese hekurudhore (tabela 5).

Gjithashtu, ARH si përgjegjës edhe për regjistrimin nacional të mjeteve lëvizëse hekurudhore NVR, me kërkesë të GCF - GENERALE COSTRUZIONI FERROVIARIE S.p.A te datës 30.08.2023, bazuar në njoftimin nga INFRAKOS SH.A me nr. 8/594 të dt.: 28.08.2023 si dhe njoftimin nga Departamenti i Sigurisë për vazhdimin e njohjeve të autorizimeve i dt.: 30.08.2023, ka lëshuar njoftimin për mos-regjistrim të 32 makinerive/mjete lëvizëse hekurudhore punuese (tabela 2) të cilat do të zhvillojnë punimet vetëm në linja të mbyllura (ashtu siç është siguruar nga GENERALE COSTRUZIONI FERROVIARIE S.p.A - GCF dhe Infracos) dhe për të cilat GCF ka marrë njoftimin e njohjes së autorizimeve të përkohshëm nga Departamenti i Sigurisë/ARH.

Tabela 5. Makineria / mjetet levizëse hekurudhore punuese

Nr.	Përshkrimi i mjetit	Modeli	Numri identifikues
1	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173110-3
2	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173111-1
3	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173112-9
4	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173113-7
5	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173114-5
6	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173115-3
7	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173116-1
8	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173117-9
9	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173118-7
10	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173119-5
11	Carro/Carrozza	PIANALE RMMS	IT-RFI 173120-2
12	Carro/Carrozza	RGMMS	IT-RFI 174079-0
13	Carro/Carrozza	RGMMS	IT-RFI 174080-7
14	Carro/Carrozza	RGMMS	IT-RFI 174081-5
15	Carro/Carrozza	RGMMS	IT-RFI 174084-9



16	Caricatore idraulico strada ro	T 10000 FS	IT-RFI 010557-3
17	Caricatore idraulico strada ro	T 10000 FS	IT-RFI 010833-7
18	Caricatore idraulico strada ro	V 804 FS+	IT-RFI 011017-6
19	Rincalzatrice	B 45 D	IT-RFI 030292-1
20	Profilatrice	R 21 L	IT-RFI 060122-4
21	Profilatrice	PROFILATRICE	IT-RFI 060133-1
22	Carro/Carrozza	RGS	IT-RFI 170016-6
23	Carro/Carrozza	CT FACCS	IT-RFI 170203-9
24	Carro/Carrozza	FACCS	IT-RFI 172054-4
25	Carro/Carrozza	FACCS	IT-RFI 172056-0
26	Carro/Carrozza	FACCS	IT-RFI 172058-6
27	Carro/Carrozza	FACCS	IT-RFI 172060-1
28	Carro/Carrozza	FACCS	IT-RFI 172063-5
29	Carro/Carrozza	CARRO TRAMOGGIA	IT-RFI 172115-4
30	Carro/Carrozza	CARRO TRAMOGGIA	IT-RFI 172280-5
31	Locomotore	GG 1600 BB	IT-RFI 270055-3
32	Locomotore	KHD 1200 BB	IT-RFI 270206-2

Po ashtu në vitin 2023, Organi i Sigurisë ka lëshuar dy autorizime për futje në shërbim për dy mjete lëvizëse të mirëmbajtjes hekurudhore të cilat janë në pronësi të Menaxherit të infrastrukturës Infrakos.

11. Azhurnimi i Regjistrave

11.1. Regjistri i Licencave në kuadër të ARH-së

Sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës ARH mban dhe azhurnon regjistrat për të gjitha llojet e licencave të lëshuara në sektorin hekurudhor. Duke ju përgjigjur kësaj kërkesë ligjore të lartcekur, ne si ARH kemi krijuar dhe azhurnuar rregullisht të gjithë regjistrat ekzistues për të gjitha llojet e licencave, dhe se një gjë të tillë e kemi bërë edhe gjatë vitit 2023. Qëllimi i këtyre regjistrave është që çdo person fizik apo juridik, i cili ka nevojë dhe interes të ketë informacione për sektorin hekurudhore në Republikën e Kosovë, një gjë të tillë mund ta bëjë në mënyrë shumë të lehtë dhe praktike në ueb faqen e ARH-së. Ne si ARH, kujdesemi gjithashtu, në njërën anë, që këta regjistra të mos përmbajnë informacione të natyrës konfidenciale sipas kornizës ligjore në fuqi, e që do mund t'i dëmtonte ndërmarrjet e licencuara.

11.2. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave

Në vijim të procesit të reformës për thjeshtimin e lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit (ZL- ZKM), me mbështetje të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - (GIZ), ka filluar analizën e inventarizimit dhe thjeshtimit të



lejeve dhe licencave për agjencitë rregullatore dhe harmonizimit të të njëjtave me Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave (LSLL), ligje ky i cili ka për qëllim vendosjen e rregullave dhe të parimeve për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës.

Një analizë e tillë kishte për qëllim që të pasqyrojë të gjeturat dhe rekomandimet e përgjithshme dhe konkrete, për thjeshtimin e procedurave për aplikim, shqyrtim dhe pajisjen me leje dhe licenca në agjencitë rregullatore, si dhe të bëjë harmonizimin e lejeve dhe licencave përmes zbatimit të disa parimeve dhe kërkesave të cilat përcaktohen në LSLL si dhe në LPPA.

Lidhur me këtë ne si ARH, përveç se kemi pasur komunikime, kemi marrë pjesë dy here në këto takime të organizuara nga zyra ligjore e ZKM-së ku kemi sqaruar në tërësi procesin e lëshimit të licencave apo lejeve komfor Ligjit për Hekurudhat e Kosovës. Për më tepër, kemi paraqitur edhe rekomandimet tona në draft raportin për harmonizimin dhe thjeshtësimin e lejeve dhe licencave për ARH-në, përpara se të miratohej ky raport në Qeveri.

Po ashtu ne emër të projektit “Vlerësimi i gatishmërisë për digjitalizimin e licencimit dhe lejeve në Kosovë”, i zbatuar nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), anëtare e Grupit të Bankës Botërore në partneritet me Konfederatën Zvicerane, respektivisht Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike – SECO që realizohet nga kompania konsulente e kontraktuar REAKTIV, ne të cilën rishikohet tërësisht korniza ligjore e Republikës së Kosovës dhe infrastruktura ekzistuese e IT-së, si dhe gatishmëria e institucioneve qeveritare dhe organeve të tjera të sektorit publik për lëshimin digjital të lejeve dhe licencave.

Në lidhje me fillimin e këtij aktiviteti, ARH ka zhvilluar disa takime me ekipin punues të këtij pilot projekti, përmes të cilave kemi shprehur gatishmërinë e institucionit tone dhe nevojën e domosdoshme lidhur me procesin e digjitalizimit të shërbimeve të cilat i ofrojmë.

11.3. Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse (NVR)

Regjistri NVR përfshinë të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të regjistruara që qarkullojnë në rrjetin hekurudhor të Kosovës. Bazuar në regjistrimet e reja, ato të modifikuara si dhe ato të tërheqjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore, ARH në përputhje me kërkesat që dalin nga korniza ligjore nacionale është e obliguar të azhurnojë/përditësoj regjistrin ad-hoc me të gjitha informatat e nevojshme të mjeteve lëvizëse hekurudhore të regjistruara, referuar si Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse (NVR).

Informacionet e përgjithshme për çdo mjet të regjistruar në NVR janë:

- pronarin e mjetit;
- vitin e prodhimit.



- mbajtësin/administruesin e mjetit lëvizës
- entitetin përgjegjës për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse;
- autorizimet e marra për vendosjen në shërbim;
- kufizimet në përdorimin e mjeteve, etj.;

Regjistri nacional i mjeteve lëvizëse hekurudhore siguron qasje në informatat kyçe në lidhje me mjetet hekurudhore që operojnë në rrjetin e hekurudhave të Kosovës. Detyrimi i regjistrimit vlen për të gjitha mjetet hekurudhore që kanë autorizim për futje në shërbim.

Përgjatë këtij viti kemi realizuar regjistrimin e mjeteve lëvizëse të mirëmbajtjes (nëntë (9) regjistrime), aplikuar nga menaxheri i infrastruktures hekurudhore Infrakos. Mjetet e regjistruara i janë bashkangjitur Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR).

Departamenti i Interoperabilitetit ka shqyrtuar të gjithë formularët e regjistrimit konform legjislacionit në fuqi dhe në afat kohor të përcaktuar në rregulloren e regjistrimit nr. 05/2012. Regjistrimi i mjeteve lëvizëse duke përfshirë „regjistrimet“, rregullohet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, Direktivën për Interoperabilitet 2008/57/EC dhe Rregulloren nr. 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse miratuar nga ARH.

Ndërsa, në dt. 19.12.2023 është parashtruar kërkesë për ç’regjistrimin e mjeteve TRAINKOS nga NVR të cilat janë shitur si skrap. Departamenti përgjegjës për Interoperabilitet ka filluar me procesin e tërheqjes së regjistrimit të mjeteve lëvizëse, ashtu siç parashihet në Rregulloren 05/2012 për regjistrimin nacional të mjeteve lëvizëse NVR.

.

Ndërlidhja e Regjistrin NVR me Regjistrin Elektronik të Bashkimit Evropian

Në përputhje me përgjegjësitë, që nga viti 2012 me asistencën profesionale dhe në bashkëpunim me konsulentët e BE-së, ARH ka zhvilluar Regjistrin Nacional të të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore, në të cilin proces, në mungesë të kodit shtetëror të hekurudhave, ka shfrytëzuar një kod të përkohshëm "00" vetëm për nevojat e brendshme, përmes të cilit është mundësuar krijimi i regjistrin NVR – Regjistri Nacional i mjeteve lëvizëse. Megjithatë, të vetëdijshëm se kjo ishte një zgjidhje *ad hoc* dhe nuk vlente për shtetet tjera, ARH nuk ka rreshtur duke e ngritur si çështje të hapur në thujtje të gjitha takimet me përfaqësuesit e BE-së, përfshirë edhe ato raportuese para Komisionit Evropian, se kjo çështje kërkon mbështetjen nga mekanizmat e BE-së dhe institucionet relevante në sektorin e hekurudhave në nivel ndërkombëtar, në mënyrë që të kemi një zgjidhje konkrete që do ta mundësonte ndërlidhjen e regjistrin NVR me regjistrin elektronik EVR - European Vehicle Register.

Si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të ARH-së, me dt.: 22.08.2023 përmes përfaqësuesit nga Agjensioni Evropian i Hekurudhave - ERA, jemi njoftuar që Drejtori Ekzekutiv i ERA - së , ka vendosur më 21 qershor 2023 që Kosova do të jetë në gjendje të përdorë kodin numerik dyshifror



"00" për "të gjitha shtetet/territoret e tjera përkohësisht derisa të gjendet një zgjidhje përfundimtare, ashtu siç është sqaruar në pikën xxx të këtij raporti.

Tani, nga ky vendim do të mundësohet qasja e Kosovës (Regjistrit Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore - NVR (National Vehicle Railway) në Regjistrin Evropian të Mjeteve Lëvizëse - EVR (European Vehicle Register) në nivel të Bashkimit Evropian).

Përtej kësaj, ERA do të organizojë sesione trajnimi për zyrtaret përgjegjës për regjistrim të ARH-së në lidhje me ndërlidhjen e regjistrit NVR me regjistrin EVR.

11.4. Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendore rreth HK-së

ARH ka të krijuar listën e marrëveshjeve ndërkufitare, e cila përfshinë marrëveshjet ndërkombëtare të arritura në mes të institucioneve dhe kompanive në sektorin hekurudhor, e cila gjatë vitit azhurnohet përmes marrëveshjeve të reja ose atyre që pësojnë ndryshime. Në listë janë të përfshira edhe marrëveshjet vendore të menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore mbi operimin dhe mirëmbajtjen. Me kërkesë të ARH-së palët nënshkruese njoftojnë ARH-në mbi marrëveshjet e nënshkruara, të cilat i bashkëngjiten listës së këtyre marrëveshjeve. Azhurnimi i fundit është realizuar në muajin korrik 2023.

Tabela 6. Marrëveshjet ndërkufitare dhe vendore hekurudhore të Kosovës

Nr.	Marrëveshjet	Palët nënshkruese	Data e nënshkrimit
1	Marrëveshja e përkohshme ndërmjet NHT"BEograd" dhe HEKURUDHAT E UNMIK-ut të	HEKURUDHAT E UNMIK-ut -NHT"BEograd"	31.05.2002 (nuk implementohet)
2	Marrëveshja e përkohshme në mes HEKURUDHAT MAQEDONE dhe HEKURUDHAT E UNMIKU-ut	HEKURUDHAT E UNMIKU-ut - HEKURUDHAT MAQEDONE	30.08.2002
3	Marrëveshja ndërmjet , Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar	Qeveria e Republikës së Kosovës - Qeveria e Republikës së Maqedonisë	15.09.2011
4	Marrëveshja për mirëmbajtje të binarit industrial	"NEW CO FERRONIKELI COMPLEX LLC" - "INFRAKOS" SH.A.	27.02.2012



5	Marrëveshja ndërkombëtare për kalimin ndërkufitar ndërmjet "INFRAKOS" SH.A. – Kosovë dhe H.M. "INFRASTRUKTURA" - Maqedoni	"INFRAKOS" SH.A. –H.M. "INFRASTRUKTURA"	Pa-finalizuar
6	Marrëveshja ndërmjet TRAINKOS SH.A. dhe INFRAKOS SH.A. për shërbime të përbashkëta	TRAINKOS SH.A. - INFRAKOS SH.A.	16.04.2019
7	Marrëveshja për qasjen në binarë dhe "INFRAKOS" SH.A. "TRAINKOS" SH.	TRAINKOS SH.A. - INFRAKOS SH.A.	Finalizuar
8	Marrëveshja për transport të mallrave ndërmjet "NEW CO FERRONIKELIN COPLEX LLC dhe TRAINKOS Sh.A.	"NEW FERRONIKELIN COPLEX LLC" CO - TRAINKOS Sh.A.	Finalizuar
9	Marrëveshjen për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse ndërmjet NEW CO FERRENKELIN COPLEX LLC dhe TRAINKOS Sh.A.	"NEW FERRENKELIN COPLEX LLC" CO - TRAINKOS Sh.A.	Finalizuar
10	Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë-Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës,	H.M. "INFRASTRUKTURA" H.M. "TRANSPORTI" - "TRAINKOS" SH.A. "INFRAKOS" SH.A.	15.02.2016
11	Dispozitat e përbashkëta për rregullimin e Komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Vollkovë-Hani I Elezit	H.M. "INFRASTRUKTURA" H.M. "TRANSPORTI" - "TRAINKOS" SH.A.	15.02.2016



		"INFRAKOS" SH.A.	
12	Marrëveshjen për qasjen në binarë ndërmjet RAILTRANS L.L.C. dhe INFRAKOS SH.A.	"RAILTRANS L.L.C." - "INFRAKOS SH.A."	07.10.2016
13	Marrëveshje për bashkëpunim të ndërsjelltë për transportin hekurudhor	"RAILTRANS L.L.C." - "MZ TRANSPORT AD-SKOPJE"- MACEDONIA	14.02.2017
14	Kontratë për mirëmbajtje ,servis dhe riparim të lokomotivave	"RAILTRANS L.L.C." - "EXPRESS SERVICE Ltd"- RUSE ,BULGARIA	10.05.2016

11.5. Aktivitetet për rritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore

11.5.1. Raporti Vjetor i Sigurisë

Organi përgjegjës për Sigurinë hekurudhore konform Ligjit të hekurudhave, duhet të përpiloj raportin vjetor në lidhje me sigurinë. Ky raport duhet të përfundohet dhe dorëzohet deri në fund të shtatorit të vitit vijues në përputhje edhe me Direktivën 2004/49/EC.

Çdo vit Menaxheri i Infrastruktura dhe Ndërmarrjet Hekurudhore paraqesin raportin vjetor të sigurisë në lidhje me vitin kalendarik të mëparshëm tek organi përgjegjës për sigurinë. Raporti vjetor i përgatitur nga Organi i Sigurisë hekurudhore është i bazuar në të dhënat e dorëzuara në raportet e sigurisë të MI dhe NH, si dhe nga aktivitetet e Organit të Sigurisë nga viti 2022.

Raporti përshkruan të gjitha informatat e sigurisë që kanë të bëjnë me sigurinë hekurudhore, ndryshimet në legjislacion, zhvillimet në certifikatën e sigurisë dhe autorizimit të sigurisë, raportet nga mbikëqyrja e Menaxherit të infrastrukurës dhe të Ndërmarrjeve hekurudhore, mirëmbajtjen e infrastrukurës dhe mjeteve lëvizëse etj.

Menaxheri i infrastrukurës hekurudhore Infracos, si dhe Ndërmarrjet hekurudhore Trainkos dhe Railtrans, brenda afatit ligjor kanë dorëzuar në ARH raportet vjetore të sigurisë për vitin 2022. Bazuar në raportet vjetore të Menaxherit të infrastrukurës, dy Ndërmarrjeve hekurudhore si dhe bazuar në informatat e mbledhura nga aktivitetet e organit të sigurisë gjatë vitit 2022, me datë 29.09.2023 është finalizuar raporti vjetor i Sigurisë hekurudhore.

11.6. Fushate vetëdijësuese për të drejtat e udhëtarëve

Me qëllim ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e udhëtarëve për të drejtat e tyre në transportin hekurudhor, ARH, ndjekur praktikën e viteve të kaluara, edhe gjatë vitit 2023 ka organizuar fushatën vetëdijësuese për të drejtat e udhëtarëve. Janë ndërmarrë të gjitha veprimet konkrete që



t'u shpjegohet për së afërmi udhëtarëve të cilët përdorin transportin hekurudhor se cilat të drejtat e udhëtarëve në transportin hekurudhor, duke parë dhe vlerësuar që qytetarët kanë mungesë të informacionit rreth të drejtave të tyre në tren.

Departamenti përgjegjës i Rregullimit të Tregut, bazuar në Rregulloren për të Drejtat e udhëtarëve 03/2017, fillimisht ka përgatitur Plan Projekt për fushatën vetëdijesuese për të Drejtat e udhëtarëve, përcjellur me planin e veprimit.

Fushata është realizuar gjatë muajit maj, brenda në tren dhe stacione në relacionin Prishtinë-Pejë dhe anasjelltas ku janë shpërndarë informacione të rëndësishme, ku secili udhëtar është pajisur me nga një broshurë që të informohet sa ma mirë dhe qartë me të drejtat e tyre në transportin hekurudhor.



Foto 13. Pasqyron komunikimi dhe njoftimin e udhëtareve me te drejtat e tyre



12. Administrata

ARH, përkujdeset që të gjitha proceset administrative të jenë në përputhje me rregullativen ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të adresuara në kuadër të ARH-së, për këtë Departamenti i Administratës kryen këto shërbimi siç janë:

- Mbështetja e përgjithshme për strukturat e ARH-së;
- Menaxhimin e burimeve njerëzore dhe çështjeve të personelit;
- Planifikim të prokurimeve dhe menaxhim të realizimit të kontratave
- Mbikëqyrjen e çështjeve të logjistikës dhe pasurisë së ARH-së;
- Administrimin e arkivës dhe librit të protokollit
- Mirëmbajtjen e teknologjisë informative.

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore jemi të obliguar që t'i zbatojmë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me Shërbimin Civil. Staf i ARH-së janë shërbyes civil sipas ligjit, me përjashtim të anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në këtë fushë jemi të obliguar të bashkëpunojmë me Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike si dhe me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, si organ mbikëqyrës i zbatimit të legjislacionit të Shërbimit Civil.

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi në mbikëqyrjen e logjistikës dhe pasurisë së ARH-së, zbatohen rregulloret e nxjerra nga Ministria e Financave dhe rregullat nga Ministria e Administratës Publike. Po ashtu gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi në administrimin e arkivës dhe librit të protokollit, ARH zbaton Ligjin për Administrimin e Punëve në Zyrë dhe akte nënligjore që rrjedhin nga ky ligj.

12.1. Financa

Duke njohur nevojën për përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësi buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar, ARH vepron dhe operon në bazë të: Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-221, Ligjin Nr.04/L-116, Ligjin Nr.04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063 dhe Ligjin Nr.05/L-007, si dhe rregullave financiare të dala nga Ministria e Financave.

Vlerësuar si informatë përmbledhëse dhe të përgjithshme në aspektin financiar, në vitin 2023 ARH ka vazhduar me procedimin e të gjitha pagesave, dalë si obligime zyrtare të ARH-së, si dhe me inkasimin e të hyrave si rezultat i ofrimit të shërbimeve të saj në fushën e licencimit, sigurisë, rregullimit të tregut dhe interoperabilitetit. Këto të hyra bazohen në Ligjin e Hekurudhave dhe Rregulloren Nr. 01/2017 për Taksa dhe Gjoba.



Në formë tabelare janë paraqitur pasqyrat financiare për vitin 2023, si dhe rrjedhshmëria e transaksioneve financiare të ARH-së sipas kategorive buxhetore.

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Shpenzimet	Shpenzimet %
Paga dhe mëditje	241,932.00	180,246.10	180,246.10	100.00 %
Mallra dhe shërbime	105,000.00	105,000.00	84,887.78	80.84%
Shpenzime komunale	6,400.00	6,400.00	3,908.76	61.07%
Gjithsej	353,332.00	291,646.10	269,042.64	92.25%

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore, duke paraqitur të dhënat e viteve paraprake, të cilat na japin një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e ARH-së.

Tabela 8. Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH-ë për vitin e përfunduar me 31 dhejtor 2023

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH-në

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

	2023		2022		2021	
	Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti final (Ndarja) B	Realizimi C	Varianca D=C-B	Realizimi E	Realizimi F
Shënime	€	€	€	€	€	€

**Hyrja e parash së gatshme në llogari të Thesarit**

Të hyrat tatimore	8						
Të hyrat jotatimore	9	11,253.00	11,253.00	8,550.00	(2,703.00)	24,585.00	1,500.00
Të hyrat e dedikuara	10						
Grantet e donatorëve	11						
Tjera	12						
Gjithsej Pranimet		11,253.00	11,253.00	8,550.00	(2,703.00)	24,585.00	1,500.00

Daljet e parash së gatshme nga llogaritë e Thesarit

Paga dhe shtesa	2	241,932.00	180,246.10	180,246.10	-	161,987.79	195,463.97
Mallrat dhe shërbimet	3	105,000.00	105,000.00	84,887.78	(20,112.22)	83,139.43	68,393.59
Shpenzime komunale	4	6,400.00	6,400.00	3,908.76	(2,491.24)	4,263.87	4,042.96
Transfere,subvencione	5	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet kapitale	6	-	-	-	-	-	-
Rezerva		-	-	-	-	-	-
Tjerrat	7	-	-	-	-	-	-
Gjithsej pagesat		353,332.00	291,646.10	269,042.64	(22,603.46)	249,391.09	267,900.52

Shënim: Buxheti final ka ndryshime nga buxheti fillestar vetëm në kategorinë e pagave. ARH për vitin 2023 ka pasur buxhet në shumë prej 353,332.00 euro, dhe nga ky buxhet janë shpenzuar 269,042.64 euro. Në kategorinë e pagave kemi pasur buxhet fillestar në shumë prej 241,932.00 euro, ndërsa buxhet final 180,246.10 dhe nga ky buxhet final janë shpenzuar 180,246.10 euro. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kemi pasur buxhet në shumë prej 105,000.00 euro, ndërsa janë shpenzuar 84,887.78 euro. Në kategorinë e shpenzimeve komunale kemi pasur buxhet në shumë prej 6,400.00 euro, ndërsa janë shpenzuar 3,908.76 euro.

Gjatë vitit 2023 kemi realizuar të Hyra në shumë prej 8,550.00 euro. Këto të Hyra kryesisht janë nga licencimi i makinistëve, renovimi i certifikatës së sigurisë, renovimin e autorizimit të sigurisë, pagesa për regjistrimin e mjeteve lëvizëse si dhe pagesa nga aplikimi për tërheqje.



12.2.1. Paga dhe Shtesa

Tabela 9. Pasqyrat e shpenzimeve në kategorinë paga dhe shtesa

	2023				2022	2021
	GQ	Pagesat	GPD	Totali		
Përshkrimi	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Pagesat neto përmes listave të pagave		151,916.57		151,916.57	137,664.86	165,392.94
Pagesat për sindikate		-		-	-	-
Pagesa neto për punë jashtë orarit		-		-	-	-
Pagesa për punë me orar të shkurtuar		-		-	-	-
Shtesat dhe kompensime tjera		-		-	-	-
Mëditjet për delegat, komisione		-		-	-	-
Punëtorët me kontratë		-		-	-	-
Tatimi në të ardhurat personale		11,163.13		11,163.13	8,895.61	11,455.57
Kontributit pensional - punëtori		8,583.20		8,583.20	7,713.66	9,307.73
Kontributit pensional - punëdhënësi		8,583.20		8,583.20	7,713.66	9,307.73
Pagesa për vendime gjyqësore						
Gjithsej Pagesat		180,246.10		180,246.10	161,987.79	195,463.97

12.2.2. Mallra dhe Shërbime

Tabela 10. Pasqyrat e shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime

2023		2022	2021
Pagesat	THV GPD Totali		



Përshkrimi	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar	3,525.79		3,525.79	1,662.46	1,082.22	
Shpenzimet e akomodimit	3,179.03		3,179.03	2,119.70	612.00	
Meditje-udhëtimi zyrtar jashtë vendit	5,150.40		5,150.40	4,770.10	2,109.92	
Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar	1,689.82		1,689.82	1,776.18	232.30	
Shpenzimet e telefonisë mobile	4,740.00		4,740.00	5,220.00	5,895.00	
Shërbimet e arsimit - trajnimit	3,047.00		3,047.00	2,670.00	1,180.00	
Shërbime shtypje jo - marketing	435.92		435.92	270.83	345.50	
Shërbimet kontraktuese tjera	1,347.54		1,347.54	598.14	776.73	
Mobilje (me pak se 1000 euro)	395.00		395.00	-	-	
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	-		-	4,480.00	1,325.00	
Pajisje tjera	88.61		88.61	94.89	-	
Furnizime për zyrë	1,309.57		1,309.57	644.51	497.75	
Furnizim me ushqim dhe pije	4,060.20		4,060.20	4,105.76	3,462.10	
Naftë për ngrohje qendrore	7,839.40		7,839.40	7,866.40	6,018.60	
Karburant për vetura	1,085.82		1,085.82	1,144.88	1,502.02	
Regjistrimi i automjeteve	90.00		90.00	90.00	90.00	
Sigurimi i automjeteve	675.51		675.51	465.26	437.92	
Taksa komunale e regj. automjeteve	294.00		294.00	264.00	264.00	
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	11,696.40		11,696.40	11,696.40	7,662.10	
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	1,856.50		1,856.50	1,399.41	1,646.20	
Mirëmbajtja e ndërtesave	3,717.00		3,717.00	3,717.00	3,433.25	
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	12.27		12.27	61.81	10.98	
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	115.00		115.00	-	-	
Qiraja për ndërtesa	27,855.00		27,855.00	27,600.00	28,310.00	
Dreka zyrtare	682.00		682.00	421.70	300.00	
Vendimet e gjykatave	-		-	-	1,200.00	
Gjithsej Pagesat	84,887.78		84,887.78	83,139.43	68,393.59	



12.2.3. Shpenzimet Komunale

Tabela 11. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë Shpenzime Komunale

Përshkrimi	2023				2022	2021
	Pagesat	THV	GPD	Totali		
	€	€	€	€	€	€
Rryma	1,638.71			1,638.71	1,994.85	1,739.11
Uji	-			-	-	-
Mbeturinat	-			-	-	-
Shpenz.telefonike	2,270.05			2,270.05	2,269.02	2,303.85
Gjithsej Pagesat	3,908.76	-	-	3,908.76	4,263.87	4,042.96

12.2.4. Të hyrat jo tatimore

Tabela 12. Pasqyra e të hyrave jo tatimore

Përshkrimi	Shënime	2023	2022	2021	% e totalit	% e ndryshimit
		€	€	€	2023	nga 2022
Të hyrat nga taksat 1		8,550.00	24,585.17	1,500.00	100.00%	%
Të hyrat nga taksat 2					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2					%	%
Të hyrat nga licencat 1					%	%
Të hyrat nga licencat 2					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%



Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit			%	%
Tarifa për akreditim			%	%
Të hyrat nga pasuria			%	%
Pranimet tjera			%	%
Gjithsej	8,550.00	24,585.17	1,500.00	100.00%

ARH, gjatë vitit 2023 kemi realizuar të Hyra në shumë prej 8,550.00 euro. Këto të Hyra kryesisht janë nga licencimi i makinistëve, renovimi i certifikatës së sigurisë, renovimin e autorizimit të sigurisë, pagesa për regjistrimin e mjeteve lëvizëse si dhe pagesa nga aplikimi për tërheqje.

12.2.5. Subvencione dhe transfere

Tabela 13. Pasqyra në kategorinë subvencione dhe transfere

	2023				2022	2021
	GQ	THV	GPD	Totali		
Përshkrimi	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitete publike	-			-	-	-
Subvencionet për entitete kulturore	-			-	-	-
Subvencionet për entitete jo-publike	-			-	-	-
Transfere për qeveri tjera	-			-	-	-
Pagesat për përfituesit individualë	-			-	-	-
Pensionet bazë	-			-	-	-
Pensionet për invalidët e luftës	-			-	-	-
Pensionet e ndihmës sociale	-			-	-	-
Pensionet për të burgosurit	-			-	-	-
Pensionet për veteranët e luftës	-			-	-	-
Pensionet për të verbërit	-			-	-	-



Pensionet e TMK-së	-	-	-	-
Pensionet e FSK-së	-	-	-	-
Pensionet e për familjet e të rënëve	-	-	-	-
Pushimi i lehonave	-	-	-	-
Pagesat për sektorin e blegtorisë	-	-	-	-
Diversifikimi i fermave	-	-	-	-
Ristrukturimi i potencialit fizik	-	-	-	-
Pensionet e përkohshme të Trepçës	-	-	-	-
Pagesa për vendimet gjyqësore	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-



12.2.6. Shpenzimet kapitale

Tabela 14. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale

Përshkrimi	2023				2022	2021
	GQ	THV	GPD	Totali		
	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Ndërtesat e banimit	-			-	-	-
Objektet arsimore	-			-	-	-
Objektet shëndëtsore	-			-	-	-
Objektet kulturore	-			-	-	-
Objektet sportive	-			-	-	-
Rrethoja	-			-	-	-
Depo	-			-	-	-
Garazha	-			-	-	-
Fushat sportive	-			-	-	-
Ndërtimi i auto rrugëve	-			-	-	-
Ndërtimi i rrugëve regjionale	-			-	-	-
Ndërtimi i rrugëve lokale	-			-	-	-
Trotualet	-			-	-	-
Kanalizimi	-			-	-	-
Ujësjetli	-			-	-	-
Mirëmbajtja investive	-			-	-	-
Pajisje të teknologjisë informative	-			-	-	-
Kompenzimi për inflacion	-			-	-	-
Vendimet gjyqësore	-			-	-	-
Gjithsej	-			-	-	-

Tabela 1: Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale



Tabela 15. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale, subvencione dhe trenasfere, si dhe shpenzimeve kapitale për vitin 2023 (Janar –Dhejtor 2023)

Kategoritë ekonomike	Planifikimi / Ndarja fillestare dhe finale	Realizimi
	Fillestare	
11000 · PAGAT & MEDITJET	241,932.00	
11110 · Paga Neto		151,916.57
11500 · Tatimi i ndaluar në të ardhurat personale		11,163.13
11600 · Kontributi pensional nga punëtori		8,583.20
11170 · Kontributi pensional nga punëdhënësi		8,583.20
Total 11000 · PAGAT & MEDITJET		180,246.10
	Fill / 241,932.00 Fin / 180,246.10	
13000 · MALLRAT & SHËRBIMET	105,000.00	
13100 · Shpenzimet e Udhëtimit	20,500.00	
13140 · Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	4,500.00	3,525.79
13141 · Mëditje - udhëtim zyrtar jashtë vendit	9,000.00	5,150.40
13142 · Akomodim - udhëtim zyrtar jashtë vendit	4,500.00	3,179.03
13143 · Shpenzimet tjera - udhëtim zyrtar jashtë vendit	2,500.00	1,689.82
Total 13100 · Shpenzimet e Udhëtimit		13,545.04
13300 · Shërbimet e Telekomunikimit	7,000.00	
13320 · Shpenzimet e telefonisë mobile	7,000.00	4,740.00
Total 13300 · Shërbimet e Telekomunikimit		4,740.00
13400 - Shpenzimet për Shërbime	6,530.00	
13410 · Shërbimet e arsimit & trajnimit	2,800.00	3,047.00
13450 · Shërbime shtypje - jo marketing	1,000.00	435.92
13460 · Shërbime kontraktuese tjera	2,730.00	1,347.54



Total 13400 · Shpenzimet për Shërbime		4,830.46
13500 · Blerja e Mobilje >1000	5,000.00	
13501 · Mobilje	2,800.00	395.00
13503 · Kompjuter	2,000.00	-
13508 · Pajisje trafiku	100.00	-
13509 · Pajisje tjera	100.00	88.61
Total 13500 · Blerja e Mobiljeve >1000		483.61
13600 · Blerje tjera Mallra & Shërbime	7,000.00	
13610 · Furnizime për zyrë	2,000.00	1,309.57
13620 · Furnizim ushqim & pije (jo dreka zyrtare)	5,000.00	4,060.20
Total 13600 · Blerje tjera mallra & shërbime		5,369.77
13700 · Derivate & Lëndët djegëse	10,000.00	
13720 · Naftë për ngrohje qendrore	7,000.00	7,839.40
13780 · Karburant për vetura	3,000.00	1,085.82
Total 13700 · Derivate & Lëndët djegëse		8,925.22
13900 · Shërbimet e Regjistrimit & Sigurimeve	12,600.00	
13950 · Regjistrimi i automjeteve	100.00	90.00
13951 · Sigurimi i automjeteve	500.00	675.51
13952 · Taksa komunale e regjistrimit	300.00	294.00
13953 · Sigurimi i Ndërtesave dhe tjera	11,700.00	11,696.40
Total 13900 Shërbimet e Regjistrimit & Sig		12,755.91
14000 · Mirëmbajtja	6,720.00	
14010 · Mirëmbajtja dhe riparimi automjeteve	1,500.00	1,856.50
14020 · Mirëmbajtja e ndërtesave	3,720.00	3,717.00
14040 · Mirëmbajtja e teknologjisë informative	500.00	12.27
14050 · Mirëmbajtja e mobileve & pajisjeve	1,000.00	115.00
Total 14000 · Mirëmbajtja		5,700.77



14100 · Qiraja	28,200.00	
14110 · Qiraja për Ndërtesa	28,200.00	27,855.00
Total 14100 · Qiraja		27,855.00
14200 · Shpenzimet e Marketingu	500.00	
14210 · Reklamat dhe konkurset	200.00	-
14230 · Shpenzimet për informim publik	300.00	-
Total 14200 · Shpenzimet e Marketingu		-
14300 · Shpenzimet e Përfaqësimit	950.00	
14310 · Drekat Zyrtare	950.00	682.00
Total 14300 · Shpenzimet e Përfaqësimit		682.00
Total 13000 · MALLRAT & SHËRBIMET		84,887.78
	Fill / 105,000.00	
	Fin / 105,000.00	
	Fillestare	Realizimi
13200 · SHPENZIMET KOMUNALE	6,400.00	
13210 · Rryma	3,200.00	1,638.71
13230 · Mbeturinat	200.00	-
13250 · Telefoni PTK	3,000.00	2,270.05
Total 13200 · SHPENZIMET KOMUNALE		3,908.76
	Fill/ 6,400.00	
	Fin/ 6,400.00	
20000 · Subvencionet & Transferet	-	
21110 · Subvencionet për entitetet publike	-	-
22200 · Pagat për përfituesit individual	-	-
Total 20000 · Subvencionet & Transferet		-
30000 · SHPENZIMET KAPITALE	-	



31210 · Ndërtimi i autostradës	-	-
31230 · Ndërtimi i rrugëve lokale	-	-
31220 · Ndërtimi i rrugëve regjionale	-	-
31700 · Vetura zyrtare	-	-
31910 · Avancë për Investime	-	-
Total 30000 · SHPENZIMET KAPITALE		-
GJITHSEJT	Fill / 353,332.00 Fin / 291,646.10	269,042.64

Tabela 2: Detajet e shpenzimeve nga kategoritë paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale, subvencione & transfere, si dhe shpenzimeve kapitale për vitin 2023 (Janar - Dhjetor 2023).



13. Prokurimi

ARH ka kryer të gjitha aktivitetet sipas Planit të Punës dhe dinamikës së planifikuar për vitin 2023.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që kemi, sipas Nenit 21A të Ligjit 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, fillimisht kemi bërë përgatitjen e Planifikimit të Prokurimit, në të cilin janë paraparë të gjitha kërkesat për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në bazë të kërkesave të pranuar nga të gjitha njësitë e kërkesës.

Duke u mbështetur në Planin e Punës për Vitin Fiskal 2023, kemi bërë përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave me dokumentacionin përcjellës për të kërkuar nga AQP zhvillimin e procedurave për të gjitha aktivitetet sipas planifikimit dhe nevojave të ARH-së, si dhe kemi përcjellë mbarëvajtjen e procesit të menaxhimit dhe realizimit të kontratave për shërbime dhe furnizime për nevojat e ARH-së. ARH në mënyrë të vazhdueshme ka një bashkëpunim të ngushtë dhe efikas me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe me Agjencinë Qendrore të Prokurimit.




Figura 3. Realizimi i aktiviteve gjatë vitit 2023



13.1. Marrëdhëniet me Publikun dhe Qasja në Dokumente Publike

Me qëllim të planifikimit dhe koordinimit të Komunikimit me Publikun përmes bashkërendimit të planeve të komunikimit me planin vjetor të punës së ARH-së, zbatimit të plotë të Ligjit 06/L-081, për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregullores nr. 03/2011 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është i hapur me transparencë të plotë dhe gatishmëri për bashkëpunim me çdo mekanizëm, institucion apo organizatë që për qëllim ka ngritjen e nivelit të përgjegjësisë në Institucionet Publike. Me synim implementimin e legjislationit në fuqi për Qasje në Dokumente Publike, ne si ARH i jemi përgjegjës në formën më të mirë të mundshme çdo kërkesë që kemi pranuar për qasje në dokumente publike.

Në ueb faqen zyrtare të ARH-së në vazhdimësi paraqiten të gjitha aktivitetet e ARH-së, raportet vjetore si dhe publikohen informata me interes publik të cilat e orientojnë publikun për të drejtat e tij dhe mënyrën për qasje në dokumente publike/zyrtare. Gjithashtu në ueb faqe kemi të publikuar edhe të dhënat e zyrtarit përgjegjës për Komunikim me Publikun dhe për Qasje në Dokumente Publike.

Tabela 16. Kërkesat e pranura për qasjen në dokumentet publike, në tri vitet e fundit

2021				2022				2023			
Numri i kërkesave të pranura				Numri i kërkesave të pranura				Numri i kërkesave të pranura			
Nr. total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme	Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme	Nr. total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme
3	3	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0



14. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm

Zyra Kombëtare e Auditimit ZKA është në proces të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të ARH-së për vitin e përfunduar deri më 31 dhjetor 2023. Qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit do të jetë: Të ofrojë siguri lidhur me pasqyrat financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, përfshirë deklaratën e pranimeve dhe pagesave, deklaratën e ekzekutimit të buxhetit, shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin 2023 dhe raportet tjera duke dhënë opinion lidhur me pasqyrat financiare në fjalë. Të ofrojë siguri lidhur me pajtueshmërinë e entitetit me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira, që janë relevante për funksionimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm për PVF për vitin 2022

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ARH-së kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.



15. Shtojcat

15.1. Shtojca I - Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Republikës së Kosovës me një gjatësi prej 333,45 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,40 km. Linja e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Linjat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës, përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Këto linja kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me shtetet fqinje si me Maqedoninë e Serbinë dhe përmes tyre edhe me shtetet e tjera.

Hekurudhat e Kosovës kryesisht ndahen në dy linja:

Linja Veri – Jug:

Shtrihet nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10-të (linjë e cila ka qenë funksionale, por e njëjta për shkak të punimeve në modernizim të linjës, ka qenë linjë me përdorim të kufizuar).

Linja Verilindje - Perëndim:

Përbëhet nga tri degë:

- **Linja Lindore** - nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë:
 - Fushë Kosovë – Prishtinë 6.7 km (linjë – në përdorim),
 - Prishtinë – Bardhosh 7.9 km (linjë – në përdorim),
 - Bardhosh – Podujevë 24.3 km (linjë jashtë përdorimi),
- **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me gjithsejtë 81 km gjatësi (linjë në përdorim),
- **Linja Jug - Perëndim** nga Klina deri në Prizren me gjithsej 58.3 km gjatësi (linjë jashtë përdorimi).



RAILWAY NETWORK
OF KOSOVO



Figura 4. Harta e Hekurudhve në Republikën e Kosovës



15.2. Shtojca 2. Statistika nga Departamenti i Sigurisë

Tabela 17. Jane paraqitur aksidentet dhe incidentet te cilat kanë ndodhur nëpër komuna gjatë viteve 2019-2023

Periudha	2019		2020		2021		2022		2023	
Komuna	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident
Prishtinë	1	3	0	3	1	3	1	0	0	2
Fushë Kosovë	1	2	0	1	1	2	2	1	2	1
Drenas	0	4	0	1	0	4	1	0	0	2
Klinë	0	1	0	0	0	1	1	0	2	1
Pejë	1	3	0	2	1	3	2	0	0	2
Lipjan	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0
Ferizaj	0	1	0	3	0	1	0	0	0	0
Kaçanik	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0
Hani i Elezit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Obiliq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vushtrri	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mitrovicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejtë	16		11		18		8		12	

Tabela 18. Janë paraqitur ngjarjet e jashtëzakonshme, numeri i personave të vdekur, numeri i personave të lënduar dhe dëmet materiale në Hekurudhat e Kosovës, për periudhën pesë vjeqare 2019-2023

	Nr. i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Nr. i personave të vdekur	Nr. i personave të lënduar	Dëmet materiale në hekurudhat e Kosovës
2019	16	5	11	0.00 €
2020	11	0	7	2970.00 €
2021	18	2	20	2773.00 €
2022	8	0	8	100.00 €
2023	12	1	7	1700.20 €



Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme për pesë vitet e fundit (2019-2023).




Figura 5. Numeri i ngjarjeve të jashtëzakonshme

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur numri i personave të vdekur në pesë vitet e fundit (2019-2023).




Figura 6. Numeri i personave te vdekur



Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur numri i personave të lënduar në pesë vitet e fundit (2019-2023).




Figura 7. Numeri i personave të lënduar

Në diagramin e më poshtëm janë paraqitur të dhënat për dëmet materiale në hekurudha në pesë vitet e fundit 2019-2023.




Figura 8. Dëmet materiale



15.3. Shtojca 3.Statistika të Tregut Hekurudhor

Tabela 19. Transporti i mallrave në neto/ton për vitet 2021/22/23

Operatorët	Transporti i mallrave në neto/ton për vitin 2021	Transporti i mallrave në neto/ton për vitin 2022	Transporti i mallrave në neto/ton për vitin 2023
Trainkos	538100.49	23165.07	195669.55
RailTrans	3974.11	0	0
Totali	542074.60	23165.07	195669.55




Figura 9. Transporti i mallrave në neto/ton për vitet 2021/22/23



Tabela 20. Transporti i udhëtarëve për vitet 2021/22/23

Operatori	Numri i udhëtarëve për vitin 2021	Numri i udhëtarëve për vitin 2022	Numri i udhëtarëve për vitin 2023
Trainkos	61081	74853	70517




Figura 10. Transporti i udhëtarëve për vitin 2021/22/23



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



RAPORTI VJETOR I SIGURISË 2022



28/09/2023

Rr. Rustem Statovci nr. 29
Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 22 00 40
Fax: +38338 22 33 40
Ueb: www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

PËRMBAJTJA

A. PARATHËNIE	3
1. Qëllimi, fushëveprimi dhe të dhënat tjera të raportit.....	3
B. PJESA HYRËSE	4
1. Hyrje në raport.....	4
2. Shtrirja e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës	5
3. Lista e Menaxherëve të Infrastrukturës (MI) dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (NH)	6
4. Analizë e Përgjithshme në zhvillimet e sigurisë hekurudhore, autorizimi / certifikimi i sigurisë, si dhe autorizimi i futjes në shërbim etj.	7
5. Autorizimi i Sigurisë dhe Certifikata e Sigurisë.....	11
6. Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit	12
C. Organizimi	13
1. Prezentimi i organizimit	13
2. Struktura Organizative e ARH-së është paraqitur në Aneksin B.	14
D. Zhvillimet në Sigurinë Hekurudhore	14
1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë	14
2. Analizimi i detajuar i trendit të të dhënave.....	15
3. Zhvillimet në sigurinë hekurudhore dhe Definicionet e zbatueshme janë paraqitur në aneksin C	19
E. Ndryshime të rëndësishme në legjislacion , rregullore dhe dispozita administrative.....	200
F. Zhvillimi i Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë.....	211
1. Legjislacioni nacional - data e aplikimit - disponueshmëria	211
2. Inspektimi i linjave hekurudhore	222
3. Inspektimi i mjeteve lëvizëse	29
Aneksi A - Struktura e Informacioneve Hekurudhore	34
Aneksi B - Struktura Organizative	38
Aneksi C.....	42
Shkurtesat:.....	44

A. PARATHËNIE

1. Qëllimi, fushëveprimi dhe të dhënat tjera të raportit

ARH- respektivisht Departamenti i Sigurisë edhe për vitin 2022 ka përgaditur raportin vjetor të sigurisë. Përgatitja e këtij raporti rrjedh si rezultat i obligimit ligjor të nenit 20 të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës si dhe nga neni 18 i Direktivës 2004/49/EC për Sigurinë hekurudhore të Bashkimit Evropian (BE). Nga Organi i Sigurisë kërkohet që të përgatitet dhe të publikohet RVS. Raporti mbulon aktivitetet kryesore të sigurisë e cila përfshinë periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022. Qëllimi i këtij RVS është që të ofrojë informacion në lidhje me nivelin e sigurisë hekurudhore.

Ky raport i sigurisë për vitin 2022 mbulon aktivitetet e sigurisë të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), respektivisht aktivitetet e Organit të Sigurisë gjatë vitit 2022, ky është raporti i njëmbëdhjetë (11) me radhë të cilin e paraqesim të Drejtori i Përgjithshëm. Objektivat dhe përmbajtja e raportit janë të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës.

Ky raport i përshkruan aktivitetet e vitit paraprak të Organit të Sigurisë, Menaxherit të Infrastrukturës (MI) dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (NH). Informacionet kryesore që i përmban raporti janë:

- b. zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS),
- c. ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativ në lidhje me sigurinë hekurudhore,
- b. zhvillimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë,
- c. rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e MI dhe të NH,
- d. përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Bashkimi Evropian, Agjensioni për hekurudha (European Railway Agency- ERA), dhe përmban të gjitha çështjet të cilat janë paraqitur në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.



Figura 1.

B. PJESA HYRËSE

1. Hyrje në raport

Raporti Vjetor i Sigurisë përgatitet nga Organi i Sigurisë në kuadër të ARH-së, ashtu siq parashihet me Ligjin 04/L-063 Neni 20 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, si dhe me nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) e Bashkimit Evropian Agjensioni për Hekurudha (ERA).

Raporti i sigurisë përgatitet duke u bazuar në radhë të parë nga informacioni i siguruar nga aktivitetet e Organit të sigurisë të cilat janë kryer gjatë vitit raportues si dhe nga informatat e raporteve vjetore të:

- 1.1. Menaxherit të Infrastrukturës (MI)-Infrakos, i cili ka një autorizim të vlefshëm të sigurisë që nga janari i vitit 2013, ky autorizim është rinovuar me datë 30.03.2018.
- 1.2. Ndërmarrjes Hekurudhore (NH)-Trainkos, e cila ka një certifikatë të vlefshme të sigurisë që nga janari i vitit 2013, kjo certifikatë është rinovuar me datë 30.03.2018.
- 1.3. Ndërmarrjes Hekurudhore (NH)-Railtrans, e cila ka një certifikatë të vlefshme të sigurisë që nga tetori i vitit 2016, kjo certifikatë është rinovuar me datë 04.10.2021.

2. Shtrirja e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës

Hartat e bashkangjitura (Aneksi A. 1.) tregojnë të gjithë rrjetin hekurudhor në Republikën e Kosovës. Rrjeti hekurudhor në Republikën e Kosovës është i ndarë në këto linja:

- ❖ **Linja Veri – Jug** që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsej 148 km (Linjë funksionale).
- ❖ **Linja Verilindje deri në Perëndim e cila përbëhet nga tri degë:**
- ❖ **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me 45 kmgjatësi. Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale) Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo - funksionale)
- ❖ **Linja Perëndimore** , Fushë Kosovë-Pejë me 81 km gjatësi (Linjë funksionale),
- ❖ **Linja Jug-Perëndim**, Klinë-Prizren me 58 km gjatësi.
 - Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale)
 - Xërxe – Prizren 23 (Linjë jo-funksionale).

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës më 01.09.2011 është bërë ndarja e Hekurudhave të Kosovës SHA në dy kompani të reja:

- ❖ Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS SH.A, dhe
- ❖ Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS SH.A.

Hekurudhat në Kosovë kanë një histori të gjatë, gjegjësisht në vitin 1874 u ndërtua linja e parë hekurudhore në Kosovë në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Ishte ky fillimi i shtrirjes së rrjetit hekurudhor nëpër Kosovë, aq sa i rëndësishëm për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, po aq i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit. Në vitin 1931 vazhdoj ndërtimi i kësaj linjës në relacionin Mitrovicë – Leshak, më 1934 ajo Fushë Kosovë – Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë – Pejë, më 1949 Prishtinë – Podujevë – Livadhi dhe më 1963 Klinë – Prizren.

Hekurudhat e Kosovës kanë një shtrirje në territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,951 km linjë e hapur hekurudhore, me një gjatësi prej 105,784 km në stacione dhe 103,4 km linja industriale. Hekurudhat e Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës në veri dhe lindje janë të lidhura me Serbinë, ndërsa përmes Hanit të Elezit, në jug me Maqedoninë.

3. Lista e Menaxherëve të Infrastrukturës (MI) dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (NH)

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i Menaxherëve të Infrastrukturës që ka një Autorizim të vlefshëm të sigurisë Pjesa A dhe B, si dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore të cilat gjithashtu kanë një Certifikatë të vlefshme të Sigurisë Pjesa A dhe B.

Nr.	Emërtimi i kompanisë
1	Menaxheri i Infrastrukturës – Infrakos SH.A.
2	Ndërmarrja hekurudhore – Trainkos SH.A.
3	Ndërmarrja hekurudhore – Railtrans L.L.C.

Tabela 1.

4. Analizë e Përgjithshme në zhvillimet e sigurisë hekurudhore, autorizimi / certifikimi i sigurisë, si dhe autorizimi i futjes në shërbim etj.

Në tabelat e më poshtme janë paraqitur të dhënat mbi menaxherin e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore të cilat kanë një autorizim të vlefshëm të sigurisë (Infrakos), si dhe një certifikatë të vlefshme të sigurisë (Trainkos dhe Railtrans).

4.1. Menaxheri i Infrastruktures hekurudhore

Nr	Emërtimi i kompanisë	Autorizimi i sigurisë pjesa A dhe B	Autorizimi i sigurisë pjesa A dhe B e rinovuar	Aktive
1	Menaxheri i Infrastrukturës (Infrakos)	24.01.2013 24.01.2013	30.03.2018 30.03.2018	Po Po

Tabela 2.

4.2. Ndërmarrjet hekurudhore

Nr	Emërtimi i kompanisë	Certifikata e sigurisë pjesa A dhe B	Certifikata e sigurisë pjesa A dhe B e rinovuar	Aktive
1	Ndërmarrja Hekurudhore (Trainkos)	24.01.2013 24.01.2013	30.03.2018 30.03.2018	PO PO
2	Ndërmarrja Hekurudhore (Railtrans)	04.10.2016 04.10.2016	04.10.2021 04.10.2021	PO PO

Tabela 3.

Gjatë vitit 2022, kanë ndodhur 8 aksidente dhe incidente, ndërsa në vitin 2021 kishte 18 aksidente dhe incidente, nëse e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2022, ka një rënie prej 55.55 %.

Numri i personave të cilët janë lënduar në vitin 2022 është 8, ndërsa në vitin 2021 kishte 20 persona të lënduar, nëse e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2022, ka një rënie të numrit të lënduarve prej 60 %.


Në vitin 2022, numri i viktimave ishte 0, ndërsa në vitin 2021 numri i viktimave ishte 2, nëse e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2022, ka një rënie të numrit të vdekurve prej 100 %.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur në aksidentet dhe incidentet të cilat kanë ndodhur nëpër komuna gjatë viteve 2018-2022.

Ngjarjet e Jashtëzakonshme nëpër komuna për vitet 2018-2022										
Periudha	2018		2019		2020		2021		2022	
Aksident incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident	Aksident	Incident
Komuna										
Prishtinë	0	3	1	3	0	2	0	1	1	0
Fushë Kosovë	0	1	1	2	0	4	0	3	2	1
Drenas	0	1	0	4	0	1	0	0	1	0
Klinë	0	0	0	1	0	0	1	4	1	0
Pejë	0	2	1	3	0	3	1	3	2	0
Lipjan	1	1	0	0	0	1	0	3	0	0
Ferizaj	0	3	0	1	0	0	0	2	0	0
Kaçanik	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0
Hani i Elezit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Obiliq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vushtrri	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mitrovicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejtë	19		16		11		18		8	

Tabela 4.

Në diagramin e mëposhtëm janë paraqitur aksidentet dhe incidentet të cilat kanë ndodhur në komunat përkatëse përgjatë vitit 2022. Siç shihet numri më i madh i aksidenteve dhe incidenteve ka ndodhur në komunën e Fushë Kosovës, gjithsej tre (3).




Diagrami 1.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura ngjarjet e jashtëzakonshme, numri i personave të vdekur, numri i personave të lënduar dhe dëmet materiale në hekurudhat e Kosovës, për periudhën pesë vjeçare (2018-2022).

	Nr. i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Nr. i personave të vdekur	Nr. i personave të lënduar	Dëmet materiale në hekurudhat e Kosovës
2018	19	3	14	1490.00 €
2019	16	5	11	0.00 €
2020	11	0	7	2970.00 €
2021	18	2	20	2773.00 €
2022	8	0	8	100.00 €


Tabela 5.

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur numri i personave të vdekur në pesë vitet e fundit (2018-2022).




Diagrami 2.

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur numri i personave të lënduar në pesë vitet e fundit (2018-2022).



Diagrami 3.

Në diagramin e më poshtëm janë paraqitur të dhënat për dëmet materiale në hekurudha në pesë vitet e fundit 2018-2022.



Diagrami 4.

5. Autorizimi i Sigurisë dhe Certifikata e Sigurisë

Ashtu siç parashihet me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës, rregulloren e ARH-së Nr.04/2017 për metodat e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë dhe si rregulloren e ARH-së Nr.06/2018 për Certifikatë të sigurisë, po ashtu edhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloret e Komisionit Nr.1169/2010/EU, Nr.1158/2010/EU, parashohin kriteret për dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për MI dhe NH.

Secili Menaxher i Infrastrukturës (MI) së shfrytëzimit të përbashkët duhet të merr Autorizimin e Sigurisë, i cili duhet të konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë (SMS), si dhe konfirmon pranimin e dispozitave të MI për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn, mirëmbajtje

dhe operim të sigurt në infrastrukturën hekurudhore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit, kur është e përshtatshme.

Secila Ndërmarrje Hekurudhore (NH) që ka një licencë valide duhet të merr Certifikatën e Sigurisë para se t'i jepet e drejta për qasje në një infrastrukturë hekurudhore. Qëllimi i Certifikatës së Sigurisë është të ofroj dëshmi se NH ka vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë (SMS) dhe mund të plotësoj kërkesat e paraqitura në STI-të dhe në legjislacionin relevant të BE-së, si dhe në rregullat nacionale të sigurisë në ofrimin e shërbimeve për transport të sigurtë në rrjetin hekurudhor.

Gjatë vitit për të cilin po raportojmë nuk kemi pasur asnjë kërkesë për autorizim të ri apo të rinovuar të sigurisë, po ashtu nuk kemi pasur asnjë kërkesë për certifikat të re apo të rinovuar të sigurisë.

6. Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-063, për hekurudhat në Republikën e Kosovës, neni 18 paragrafi 3.1, 3.3 neni 109, 110 dhe 111 secili mjet lëvizës para se të futet në shërbim duhet të autorizohet nga Organi i Sigurisë.

Në vitit 2022, Departamenti i Sigurisë nga Kompania Italiane GCF ka pranuar dy kërkesa, një kërkesë për vazhdimin e njohjeve të Autorizimit për futje në shërbim, si dhe një kërkesë për njohjen e Autorizimeve për Futjen në Shërbim, këto mjetet levizëse punuese përdoren për ndërtimin/rehabilitimin e linjës 10 (Hani Elezit - Fushë Kosovë – Mitrovicë).

Mjeteve lëvizëse punuese hekurudhore të cilave i'u është vazhduar njohja e autorizimeve për futje në shërbim gjatë vitit 2022 janë gjithsej 13 mjetet lëvizëse punuese hekurudhore, si dhe është bërë njohja e autorizimeve për futje në shërbim edhe për 32 mjetet lëvizëse punuese hekurudhore të gjitha këto mjetet punuese janë në pronësi të Kompanisë Italiane GCF.

Po ashtu në fund të vitit 2022, Menaxheri i infrastrukturës – Infrakos ka aplikuar për autorizimin për futje në shërbim për dy mjetet lëvizëse të mirëmbajtjes hekurudhore.

C. ORGANIZIMI

1. Prezentimi i organizimit

Ashtu siç është paraparë edhe me Ligjin 04/L-063, nenit 3 paragrafi 1.42. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës – është institucion i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrje, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ i sigurisë, organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor si dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji. ARH është themeluar në vitin 2010, andaj në vitin 2022 në Departamentin e Sigurisë ka pasur tre të punësuar. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar dhe funksionon nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria mbahet dhe përmirësohet në sistemin hekurudhor të Kosovës. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendim marrjen në raport me ndonjë Ndërmarrje Hekurudhore, Menaxher i Infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit.

Bazuar në ligjin 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore i janë besuar detyrat në vazhdim:

- a. autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe kontrollimin që ato operojnë dhe mirëmbahen në përputhje me kërkesat esenciale;*
- b. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;*
- c. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;*
- d. lëshimi, përtëritja, amendamenti dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat e paraqitura në to, dhe se MI dhe NH janë duke operuar sipas ligjit në fuqi;*

- e. monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë;*
- f. mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;*
- g. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;*
- h. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës (RINF).*

ARH në rolin e autoritetit të sigurisë është gjithashtu pjesëmarrës i rregullt në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Bashkimi Evropian Agjensioni për Hekurudha (European Union Agency for Railways).

2. Struktura Organizative e ARH-së është paraqitur në Aneksin B.

D. ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE

1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë

Departamenti i Sigurisë duhet të siguroj që siguria hekurudhore në përgjithësi mirëmbahet, atëherë kur është e arsyeshme dhe e nevojshme të përmirësohet, e gjithë kjo duke marrë parasysh legjislacionin në Republikën e Kosovës dhe atë të BE-së të përshtatshëm për këtë sektor.

Në mënyrë që të kemi një mbikëqyrje më efikase organi i sigurisë përdor metodën për qasje ndaj rrezikut. Në planifikimin e aktiviteteve mbikëqyrëse jemi bazuar nga përvoja e raportimit të aksidenteve, incidenteve, inspektimeve si dhe përvojat nga proceset tjera janë përdorur në mënyrë aktive ashtu që prioritetet tona janë fokusuar kryesisht në ato aktivitete për të cilat kemi menduar se paraqesin një rrezikshmëri më të lartë.

Mirëmbajtja dhe rritja e nivelit të sigurisë në sektorin hekurudhor në masë të madhe varet nga koordinimi ndërmjet ARH-së, MMPHI, MI dhe NH, pra niveli i sigurisë në hekurudha është përshkruar në formën e objektivave për përmirësimin e sigurisë që janë zbatuar nga të gjitha palët ARH, MMPH, MI dhe NH.

Duke pasur parasysh informatat e më sipërme, ne kryesisht fokusohemi në:

- *Rreziku i cili ndërlidhet me udhëtarët, stafin (përfshirë edhe stafin e kontraktuesve),*
- *Rreziku i shfrytëzuesve të vendkalimeve (kryqëzimeve hekurudhë-rrugë) dhe të tjerëve,*
- *Rreziku duke mos paragjykuar rregullat e detyrueshme ekzistuese nacionale dhe rajonale,*
- *Rreziku lidhur me personat e pa autorizuar në objektet hekurudhore,*
- *Riskun social,*
- *Përfshirjen aktive të menaxhmentit të lartë të NH dhe MI të cilët në një formë apo tjetër janë përgjegjës për sigurinë hekurudhore (duke përfshirë vlerësimet e menaxhmentit),*
- *Udhëzime të brendshme për vendkalimet dhe pajisjet e sigurisë,*
- *Përdorimi aktiv i analizës së rrezikut (metoda e zakonshme e vlerësimit të rrezikut- CSM RA.)*

2. Analizimi i detajuar i trendit të të dhënave

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat mbi vlerësimin e arritjes së qëllimeve të përbashkëta të sigurisë (QPS) të zhvilluara në BE, Organi përgjegjës për sigurinë duhet të mbledhë informacion për treguesit e përbashkët të sigurisë (TPS) nëpërmes të raporteve vjetore të Menaxherit të Infrastrukturës (Infrakos) si dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (Trainkos dhe Railtrans) siç është përcaktuar me ligjin për hekurudhat e Kosovës Nr.04/L-063 dhe direktivës së sigurisë 2004/49/EC, ku si referencë i kemi paraqitur të dhënat për pesë vitet e fundit 2018-2022.

Numri i aksidenteve dhe incidenteve

Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Gjithsej	19	16	11	18	8

Tabela 6.

Siq mund të shihet në tabelen e më sipërme numri i aksidenteve dhe incidenteve në vitin 2022 ishte 8, ndërsa në vitin 2021 ishte 18, nëse e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2022, ka një rënie prej 55.55 %

Numri i të vdekurve

Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Gjithsej	3	5	0	2	0

Tabela 7.

Siq mund të shihet në tabelen e më sipërme numri i personave të vdekur në vitin 2022 ishte 0, ndërsa në vitin 2021 ishte 2, nëse e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2022, ka një rënie të numrit të vdekurve prej 100 %.

Numri i të lënduarve

Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Gjithsej	14	11	7	20	8

Tabela 8.

Siq mund të shihet në tabelen e më sipërme numri i të lënduarve në vitin 2022 ishte 8, ndërsa në vitin 2021 ishte 20, nëse e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2022, ka një rënie prej 60%.

Në vazhdim janë të paraqitura të dhënat e plota për trendin e ngjarjeve në vitin 2022:

- 8 Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme;
- 0 qytetarë kanë vdekur si pasojë e aksidenteve;
- 0 qytetarë kanë vdekur si pasojë e vetëvrasjes;
- 8 qytetarë kanë pësuar lëndime;

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme, numri i personave të vdekur, të vetëvrasar dhe të lënduar gjatë vitit 2022.

Viti	Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Të vdekur si pasojë e aksidenteve	Të Vetëvrasarë	Të lënduar
2022	8	0	0	8

Tabela 9.

Sipas të dhënave të ofruara gjatë vitit 2022 janë realizuar gjithsej 3,653 trena të udhëtarëve, ndërsa në vitin 2021 ka pasur 3,639 trena të udhëtarëve, pra ka pasur një rritje prej 14 trenave të udhëtarëve. Numri i kilometrave të kaluar të trenave të udhëtarëve gjatë vitit 2022 ishte 133,394.10 km, ndërsa në vitin 2021 ishte 132,838.30 km, duke krahasuar vitin 2021 me vitin 2022 ka një rritje të kilometrave të kaluar të trenave të udhëtarëve prej 555.80 km.


Kurse sa i përket transportit të mallrave në vitin 2022 ka pasur gjithsej 394 trena, ku Trainkos ka realizuar 394 trena, kurse Railtrans ka 0 trena të mallrave. Në vitin 2021 kishte gjithsej 3,081 trena të mallrave, ku Trainkos ka realizuar 3,058 trena, kurse Railtrans 23 trena të mallrave, duke krahasuar vitin 2021 me vitin 2022 ka një rënie prej 2,687 të numrit të trenave.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar gjithsej 6,632 km të trenit të mallrave, ku Trainkos ka realizuar 6,632 km, kurse Railtrans ka realizuar gjithsej 0 km. Në vitin 2021 kishte gjithsej 6,0282.15 km të trenit të mallrave, ku Trainkos ka realizuar 60,229.55 km, kurse Railtrans ka realizuar gjithsej 52.6 km, duke krahasuar vitin 2021 me vitin 2022 ka një rënie prej 53,650.15 km.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur kilometrat e kaluara të trenit të udhëtarëve dhe të mallrave gjatë viteve 2018-2022.

Viti	Kilometrat e kaluara të trenit të udhëtarëve	Kilometrat e kaluara të trenit të mallrave
2018	172,050.00	47,436.10
2019	188,542.70	78,348.42
2020	116,983.00	47,874.00
2021	132,838.30	60,282.15
2022	133,394.10	6,632.00

Tabela 10.



Diagrami 5.

3. Zhvillimet në sigurinë hekurudhore dhe Definicionet e zbatueshme janë paraqitur në aneksin C



Figura 2.



Figura 3.

E. NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË LEGJISLACION , RREGULLORE DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Më qëllim që të harmonizohet korniza ligjore e sektorit hekurudhor në Kosovë me ato të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Parlamenti i Kosovës me datë 14.11.2011 ka miratuar Ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës (ku ligji ka hyrë në fuqi me 01.01.2012), në të cilin ligj janë transponuar plotësisht nga acquis e BE-së direktiva 2004/49; direktiva 2001/14, direktiva 91/440 dhe 95/18, direktiva 2007/59 dhe direktiva 2008/57.

Për kryerjen e detyrave sipas ligjit për hekurudhat e Kosovës, struktura e ARH-së, përfshinë: menaxhmentin, departamentet dhe personelin mbështetës, çdo departament ka funksione të përcaktuara për t'iu përgjigjur nevojave të mobilitetit të shoqërisë, transportit dhe ekonomisë, siç janë të rregulluara më këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nevojshme që nxjerrin vetë departamentet dhe menaxhmenti i ARH-së.

Organet në kuadër të ARH-së janë:

- *Organi i Sigurisë,*
- *Organi i Rregullimit të Tregut,*
- *Organi i Interoperabilitetit,*
- *Organi i Licencimit.*

Të gjitha të dhënat lidhur me ndryshimet në legjislacion, rregullore dhe dispozita administrative mund ti gjeni në ueb faqen e ARH: www.arh-ks.org

F. ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË

1. Legjislacioni nacional - data e aplikimit - disponueshmëria

Lëshimi i certifikatës dhe autorizimit të sigurisë bëhet në pajtim me nenin 94, nenin 104 të ligjit 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, nenit 10 dhe 11 të Direktivës 2004/49/EC.

Pas përgatitjes së të gjitha akteve nënligjore të domosdoshme për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë siç janë:

- Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2012 për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë,
- Rregullore për Certifikatë të Sigurisë Nr. 02/2012,
- Rregullore e ARH-së Nr. 06/2012 për regjistrimin e infrastrukturës,
- Rregullore e ARH-së Nr. 04/2017 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore,
- Rregullore Nr. 02/2018 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me Kërkesat për Marrjen e Certifikatës së Sigurisë Hekurudhore,
- Rregullore Nr.06/2018 për Përdorimin e një Formati të Përbashkët Evropian për Certifikatat e Sigurisë, dokumentet e aplikimit dhe vlefshmëria e Certifikatave të Sigurisë.

Në përputhje me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloret e Komisionit Evropian Nr. 1169/2010, Rregulloren Nr. 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për MI dhe NH.

Menaxheri i infrastrukturës Infrakos ka një autorizim valid të sigurisë të rinovuar pjesa A dhe B prej datës 30.03.2018, Ndërmarrja hekurudhore Trainkos ka një certifikatë valide të sigurisë të rinovuar pjesa A dhe B prej datës 30.03.2018, kurse ndërmarrja hekurudhore private Railtrans ka një certifikatë valide të rinovuar pjesa A dhe B prej datës 04.10.2021.

2. Inspektimi i linjave hekurudhore

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Sigurisë ka bërë inspektimin e infrastrukturës hekurudhore të të gjitha linjave ekzistuese funksionale dhe jo funksionale.

Linjat e inspektuara janë:

1. *Prishtinë-Fushë Kosovë,*
2. *Bardh -Magur,*
3. *Klinë-Prizren,*
4. *Prishtinë-Podujevë,*
5. *Fushë Kosovë-Mitrovicë,*
6. *Fushë Kosovë-Pejë,*
7. *Fushë Kosovë-Hani i Elezit,*

2.1. Në vazhdim po e paraqesim disa pjesë të raporteve të linjave të cilat janë funksionale.

2.1.1 Linjat Funksionale

Departamenti i Sigurisë në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore të parapara me Ligjin Nr. 04/L-063 neni 19 paragrafi 6, 104 paragrafi 5, si dhe në përputhje me planin e punës për vitin 2022, kemi paraparë Inspektimin e linjave hekurudhore.

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Sigurisë ka inspektuar të gjitha linjat hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore Infrakos.

Në këtë raport janë paraqitur të gjeturat gjatë inspektimit të këtyre linjave hekurudhore, të gjitha të gjeturat duhet të konsiderohen si rekomandime për linjën e inspektuar e cila është në përdorim për transport hekurudhor. Kurse për linjat të cilat janë jashtë përdorimit nuk kemi rekomandim të veçantë por ato duhet të mirëmbahen e të mos ketë dëmtim të mëtutjeshëm, në rast se ato do të futen në përdorim vlejné rekomandimet nga ky raport.

Në këtë raport janë dhënë të gjeturat gjatë inspektimit të këtyre linjave hekurudhore, të gjitha të gjeturat duhet të konsiderohen si rekomandime për linjën e inspektuar e cila është në përdorim për transport hekurudhor.

Raporti i inspektimit të linjës Prishtinë - Fushë Kosovë



Fig.1



Fig.2

Në figurat 1 dhe 2 shihet stacioni hekurudhor ne qytetin e Prishtinës, siç shihet disa traversa janë të dëmtuara, platforma në gjendje jo të mirë për shkak të shembjes dhe fshirjes së shenjzimit, ndërrueset e binarëve të vajosura, shtresa e balastit e mjaftueshme, sistemi i ndriçimit jashtë funksionit. Të fuksionalizohet sistemi i ndriçimit traversat e dëmtuara te zëvendësohen, të rregullohet platforma e stacionit



Fig.3



Fig.4

Në figurat 3 dhe 4 shihen dy vendkalime, vendkalimi i parë gjendet përball kazermës së FSK-së, vendkalimi i dytë gjendet përball ndërtesës së AKI-së. Te dy vendkalimet hekurudhore janë të pajisur me rampë mbrojtëse.



Fig.5



Fig.6

Në figurat 5 dhe 6 shihet vendkalimi ilegal i cili gjendet në kilometrin (125+120), siç shihet vendkalimi është i pajisur me shenjen STOP dhe shenjën e kryqit të Andreut në të dy anët e vendkalimit hekurudhor.



Fig.7



Fig.8

Në figurat 7 dhe 8 shihet vendkalimi ilegal i cili gjendet në kilometrin (125+120), siç shihet vendkalimi është i pajisur me shenjen STOP vetëm në njërën anë të rrugës. Ky vendkalim të pajiset me kryqin e ANDREUT në të dy anët e rrugë si dhe shenjen STOP në njërën anë të rrugës.



Fig.9



Fig.10

Në figurat 9 dhe 10 shihet vendkalimi legal i cili gjendet afërsisht në kilometrin (125+470), në rrugën Dervish Qollaku, si shihet vendkalimi është i pajisur me shenjen STOP dhe shenjen kalimi i rrugës përtej hekurudhës pa mbrojtës ose gjysmëmbrojtës. Në këtë vendkalim ka qarkullim të madh të automjeteve dhe ekziston rrezik për ndodhjen e aksidenteve, andaj me qëllim të rritjes së sigurisë ky vendkalim të pajiset me shenjat e rrezikut si dhe me rampë mbrojtëse në të dy anët e vendkalimit.



Fig.11



Fig.12

Në figurat 11 dhe 12 shihet vendkalimi ilegal i cili gjendet në afërsisht në kilometrin (126+780), siç shihet vendkalimi nuk është i pajisur me asnjë shenjë të rrezikut. Ky vendkalim të pajiset me shenjat e rreziku në të dy anët e vendkalimit.



Fig.13



Fig.14

Në figurat 13 dhe 14 shihet vendkalimi legal i cili gjendet në afërsisht në kilometrin (127+280), siç shihet vendkalimi është i pajisur me shenjat STOP dhe kryqi i Andreut në të dy anët e vendkalimit.



Fig.15



Fig.16

Në figurat 15 dhe 16 shihet vendkalimi legal i cili gjendet afërsisht në kilometrin (127+920), siç shihet vendkalimi është i pajisur me shenjën e kryqit të Andreut vetëm në njëërën anë të vendkalimit. Ky vendkalim të pajiset me shenjën STOP në të dy anë e vendkalimit si dhe me shenjën e kryqit të Andreut në njëërën anë të vendkalimit.



Fig.17



Fig.18

Në figurat 17 dhe 18 shihet vendkalimi legal i cili gjendet afërsisht në kilometrin (128+430), siç shihet vendkalimi është i pajisur me shenjën kalimi i rrugës përtej hekurudhës pa mbrojtës ose gjysmë mbrojtës. Ky vendkalim të pajiset me shenjat STOP dhe kryqi i Andreut në të dy anët e vendkalimit.



Fig.19



Fig.20

Në figurat 19 dhe 20 shihet vendkalimi legal i cili gjendet afërsisht në kilometrin (129+00), siç shihet vendkalimi është i pajisur me shenja të rrezikut, në njërën anë mungon shenja STOP. Ky vendkalim të pajiset me shenjën STOP në njërën anë të vendkalimit.



Fig.21



Fig.22

Në figurat 21 dhe 22 shihet vendkalimi legal i cili gjendet në rrugën Meshari, siç shihet vendkalimit i mungojnë shenjat e rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut. Ky vendkalim te pajiset me shenja te rrezikut, si dhe të ri funksionalizohet rampa mbrojtëse e cila ka qene funksionale.

Inspektimet e linjave hekurudhore gjatë vitit 2022		Fushë Kosovë Medvegj Magure	Prishtinë Fushë Kosovë	Fushë Kosovë Hani i Elezit	Fushë Kosovë Pejë	Prishtinë Podujevë	Fushë Kosovë Mitrovicë	Klinë Prizren
Numri i Inspektimëve	Planifikuara	1	1	1	1	1	1	1
	Pa Planifikuara	0	0	0	0	0	0	0
	Realizuara	1	1	1	1	1	1	1

Tabela 11.

3. Inspektimi i mjeteve lëvizëse

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Sigurisë ka kryer inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë në menaxhim të: Infrakos-it, Trainkos-it, Railtrans-it dhe Ferronikel-it.

3.1. Inspektimi i mjeteve lëvizëse të Infrakos-it

Departamenti i Sigurisë në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore të parapara me Ligjin Nr. 04/L-063 neni 19 paragrafi 6, neni 104 paragrafi 5, si dhe në përputhje me planin e punës për vitin 2022, kemi paraparë Inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore të Infrakos-it.

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Sigurisë ka inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore Infrakos të cilat posedojnë autorizimin për futjen në shërbim.

Mjetet lëvizëse të inspektuara janë:

1. Plasser &Theurer,
2. Atlas,
3. Iveco Daily,
4. Motor të lehtë hekurudhor,
5. Valltera.

Më poshtë po i paraqesim dy prej mjeteve levizëse të inspektuara (Pllaser dhe Motor i lehtë hekurudhor)



Fig.1

Mjeti i mirëmbajtjes Plasser & Theurer i paraqitur ne fig. 1 me numër evropian 99 00 9428 008-0 është në funksion, gjatë inspektimit kemi konstatuar karrocERIA eshte ne gjendje të mirë, trashësia e kokës së rrotave është brenda parametrave të lejuar, lidhëset e ajrit në gjendje të mirë sistemi i ndriçimit funksional, buria funksionale, mjeti i mirëmbajtjes është i pajisur me sistem kundër zjarrit të cilit i ka skaduar afati.



Fig.2

Motori i lehtë hekurudhore-Drezinë e lehtë LMD-9 i paraqitur në fig. 2 me numër identifikues nr. 081 është në funksion, sistemi i ndriçimit funksional, trashësia e kokës së rrotave është brenda parametrave të lejuar, karrocëria në gjendje të mirë.

3.2 Inspektimi i mjeteve lëvizëse të Trainkosit

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Sigurisë ka inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore në menaxhim të operatorit me trena Trainkos të cilat posedojnë autorizimin për futjen në shërbim.

Në këtë raport janë paraqitur të gjeturat gjatë inspektimit të këtyre mjeteve lëvizëse të cilat janë në përdorim dhe janë në menaxhim të Trainkos-it.

Kurse për mjetet të cilat nuk kanë autorizim të futjes në shërbim nuk i kemi inspektuar prandaj edhe nuk kemi ndonjë rekomandim për ato mjete.

Mjetet lëvizëse të inspektuara janë:

- Lokomotivat,
- Lokomotivat manovruese,
- Trenat motorik,
- Vagonët e udhëtarëve.

Më poshtë po e paraqesim inspektimin e një mjeti lëvizës-Lokomotivë

Lokomotiva në fig. 1 dhe 2, me Nr. 92 00 2640 007-6, është në gjendje funksionale, trashësia e rrotave brenda parametrave të lejuar (sipas pamjes vizuale), karrocERIA e mirë, sistemi i ndriçimit funksional, xhamat të krisur, aparati kundër zjarrit me afat, buria dhe radio lidhja funksionale, lidhëset e ajrit në gjendje të mirë, është i dokumentuar me raport testimi i frenimit.



Figura 1.



Figura 2.

Janë inspektuar:

- Trashësia e rrotave
- Dimensionet i profilit të rrotave
- Sistemi i frenimit
- Papuçet e frenimi (disk)
- Sistemi i ndriçimit
- Pajisjet kundër zjarrit
- Buria dhe Radio Lidhja
- KarrocERIA e mjetit lëvizës
- Lidhëset e ajrit dhe Çengeli
- Xhami i përparmë dhe anësor dhe fshesat e xhamave etj.

Inspektimi i llojeve të mjeteve levizese 2022		Lokomotivë	Lokomotivë Manovruese	Tren motorik	Vagonë të udhëtarëve	Vagonë të mallrave	Mjetet e mirëmbajtjes
Numri i Inspektimeve	Planifikuara	1	1	1	1	1	1
	Pa Planifikuara	0	0	0	0	0	0
	Realizuara	1	1	1	1	1	1

Tabela 12.

G. Burimet e Informacionit

Raporti vjetor i sigurisë për vitin 2022, është përgatitur bazuar në aktivitetet e Departamentit të Sigurisë gjatë vitit të lartë përmendur si dhe nga raportet e sigurisë të Infrakos-it, Trainkos-it dhe Railtrans-it.

Menaxheri i Infrastrukturës	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Infrakos Sh.A	24.05.2023
Ndërmarrja hekurudhore (NH)	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Trainkos Sh.A	08.06.2023
Ndërmarrja hekurudhore (NH)	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Railtrans	14.06.2023

Tabela 13

ANEKSI A - STRUKTURA E INFORMACIONEVE HEKURUDHORE

A.1 Harta e rrjetit hekurudhor



Fig. 26.




Fig. 27.




Fig. 28.

A.2 Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore (NH)

A2.1 Menaxheri i Infrastrukturës

Emri	Adresa	Web faqja	Autorizimi i Sigurisë A-B (datë/numër)-e rinovuar	Data e fillimit të aktivitetit komercial	Gjatësia e përgjithshme e linjës/gjerësia
Infrakos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.infrakos.com	30.03.2018 KS 21 2018 001 KS 22 2018 001	23.12.2005	333.451/1435

Tab. 14.

A.2.2. Ndërmarrja Hekurudhore

Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numër)-e rinovuar	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Trainkos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.trainkos.com	30.03.2018 KS 11 2013 001 KS 12 2013 001	16.08.2011

Tab. 15.

A.2.3. Ndërmarrja Hekurudhore

Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numër)-e rinovuar	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Railtrans	Ish fabrika e Amortizatorve terminali doganor Republika e Kosovës	www.railtrans.biz	04.10.2021 KS 11 2021 001 KS 12 2021 001	06.05.2008

Tab. 16.

ANEKSI B - STRUKTURA ORGANIZATIVE

B.1. Grafiku: Organizimi i brendshëm i ARH-së gjatë vitit 2022

Figura 29.

B.2. Grafiku: Rrjedha Organizative (marrëdhëniet) ndërmjet Autoritetit Rregullativ të hekurudhave (ARH) me organet e tjera kombëtare.






Figura 30.




Diagrami 6.




Diagrami 7.

Vendkalimet në vitin 2022



Diagrami 8.



Diagrami 9.

ANEKSI C.

C.1. Definicionet e zbatueshme në pajtim me ligjin 04/L-063 për hekurudhat e Kosovë dhe Rregulloren Nr. 2003/91/EC

Person i vrarë

Do të thotë çdo person i vrarë menjëherë ose vdekur brenda 30 ditëve, si rezultat i një aksidenti, me përjashtim të vetëvrasjeve;

Person i plagosur rëndë

Nënkupton çdo person i plagosur i cili është shtruar në spital për më shumë se 24 orë, si pasojë e një aksidenti, duke përjashtuar tentim vetëvrasjet;

Km-Udhëtarëve

Nënkupton njësinë e masës që përfaqëson transportin e një udhëtari me hekurudhë gjatë një distancë prej një kilometri. Vetëm distanca në territorin kombëtar të raportimit Vendi do të merren parasysh;

Vetëvrasje

Nënkupton aktin me dashje të lëndojë veten duke rezultuar në vdekje, regjistruar dhe klasifikuar si i tillë nga autoriteti kompetent kombëtar;

Aksidenti

Nënkupton ngjarjen e padëshirueshme dhe të paqëllimtë apo zinxhirin specifik të ngjarjeve të tilla të cilat kanë pasoja dëmtuese;

Aksidenti serioz

Nënkupton ndonjë ndeshje apo rrëshqitje të trenave që rezulton në vdekjen e të paktën një personi apo lëndimet serioze të së paku pesë apo më shumë personave apo dëmtim të gjerë të mjeteve lëvizëse hekurudhore, infrastrukturës dhe mjedisit apo ndonjë aksident tjetër i ngjashme me ndikim të dukshëm në rregulloren e sigurisë hekurudhore apo në menaxhimin e sigurisë;

Incidenti

Nënkupton ndonjë ndodhi tjetër nga aksidenti apo aksidenti serioz që shoqërohet me operimin e trenave dhe që ka efekt në sigurinë e operimit;

Treni

Nënkupton kompozicionin e mjeteve lëvizëse hekurudhore duke përfshirë këtu edhe tërheqjen;

Vendkalimi

Nënkupton kryqëzimin e vijës hekurudhore me infrastrukturën rrugore në të njëjtin nivel.

SHKURTESAT:

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ERA	European Railway Agency
MI	Menaxheri i Infrastrukturës
NH	Ndërmarrja Hekurudhore
SMS	Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë
RVS	Raporti Vjetor i Sigurisë
TPS	Treguesit e Përbashkët të Sigurisë
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
RINF	Regjistri i Infrastrukturës
MPS	Metodat e Përbashkëta të Sigurisë
STI	Specifikat Teknike për Interoperabilitet
BE	Bashkimi Evropian
QPS	Qëllimet e Përbashkëta të Sigurisë